



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në

“Shkenca Politike”

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Barleti”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1 Prof.Dr. Merita Xhumari

2 . Dr. Elda Zotaj

Korrik /2023

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politike” ofruar nga Institucioni i**  
**Arsimit të Lartë “Universiteti Barleti”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Barleti
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Qeverisjes, Shkenca Politike dhe Komunikim në Fakultetin e Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	“Shkenca Politike”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	2365 12.04.2006
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	U 90 dt 23.03.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	UAMSH 561 dt 30.11 2016
8	Cikli i studimit:	I parë i studimeve
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite/ 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	n/a
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	n/a
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	
18	Numri i studentëve:	8 student 2020-2021 0 student 2021-2022 0 student 2022-2023
19	Komente / të tjera:	

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

### **Përshkrim përmbledhës (200 -400 fjalë)**

Universiteti Barleti ka marrë akreditimin institucional përfshirë edhe akreditimin e programeve të studimit nga Agjencia Kombëtare e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë në fund të vitit 2021. Programi Bachelor në Shkenca Politike ka marrë akreditimin e fundit sipas Urdhërit nr. 561, datë 30.11.2016 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për akreditimin periodik të Programit të Studimit të Ciklit të parë Bachelor në Shkenca Politike, në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike të SHLUJ Universiteti Marin Barleti, sot ofrohet nga Departamenti i Qeverisjes, Shkenca Politike dhe Komunikim në Fakultetin e Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë. Pra, nëse deri tani programi Shkenca Politike ka qenë më afër me atë të shkencave juridike, aktualisht po synon të afrohet më tepër me shkencat ekonomike, i cili është në përputhje me klasifikimin ISCED, ku si dega e ekonomisë edhe ajo e shkencave politike janë në një kategori të fushës së studimit “Shkenca Sociale”, kurse studimet juridike i takojnë fushës së studimit “Biznes dhe Drejtësi”. Kjo prirje synon ta bëjë më tërheqës programin e studimit i cili në vitin akademik 2021-2022 nuk ka rregjistruar asnjë student dhe aktualisht programi në vitin akademik 2022-2023 ka vetëm studentët e vitit të tretë.

Sa i takon strukturës organizative të institucionit për realizimin e këtij programi studimi, ajo është në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, sanksionuar në Statutin dhe Rregulloren e UniBa dhe në aktet e tjera rregullatore. Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë dhe Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë bashkëpunon ngushtë me Departamentin e Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit, koordinatoren e Departamentit dhe njësitë e tjera si zyrën e Burimeve Njerëzore, zyrën e Alumnit dhe Karrierës, zyrën e pranimeve, dekanen e studentëve dhe bashkëpunëtorët e jashtëm duke garantuar cilësinë e procesit mësimor sipas standardeve shtetërore.

Programi Bachelor në Shkenca Politike ka 180 kredite, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje 3 vite/ 6 semestra. Stafit akademik duket se përmbush standardet e cilësisë, si nga numri (7 – PAE i Departamentit) edhe nga niveli i kualifikimit (3 Dr/ 4Msc - Evidenca 20.), i cili ofron jo më tepër sesa tre module në semestër. Syllabuset përmbanin gjithë komponentët e kërkuar, format e kontrollit të njohurive për vlerësimin e studentëve të cilat duken të larmishme, literatura elektronike për programin e studimit sigurohej përmes platformave online që UniBa ofronte për stafin akademik edhe studentët.


## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

### Përshkrim përmbledhës (200-400 fjalë)

Procesi i vlerësimit paraqet të gjithë ecurinë e punës që nga shqyrtimi i dokumentacionit deri në Raportin e dorëzuar në ASCAL në kuadër të akreditimit të programit të studimit Bachelor në "Shkenca Politike" të Universitetit "Barleti". Gjithë procesi është kryer në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në përputhje me "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017".

Nisja e procedurës së vlerësimit të programit Bachelor në "Shkenca Politike", lidhet me shqyrtimin e dokumentacionit të dërguar nga Universiteti "Barleti" nëpërmjet shërbimit në AMS në faqen online të ASCAL. Çfarë të bën përshtypje në dokumentacion është rifreskimi i pothuajse të gjitha dokumenteve referuese, të cilat i takonin vitit të fundit akademik 2022-2023 dhe jo periudhës së mëparshme për të cilën kërkohet akreditimi (Evidenca 2; 11; 20; 22; 25; 28;). Ky përbën një tregues shumë pozitiv për institucionin i cili përditëson kuadrin e vet rregullator, duke reflektuar edhe rekomandimet për përmbushjen e standardeve të ASCAL.

RVB që shërbeu si orientues për GVJ përpara vizitës në institucion, ishte hartuar në kuadër të akreditimit periodik të tij, me Urdhër nr. 23, datë 22.11.2022 të Rektorit të Universitetit Barleti ngrihet Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për akreditimin e rradhës (Evidenca 56. RVB i programit Bachelor në Shkenca Politike). Vende vende RVB kishte referencat për vitin korrent akademik 2022-2023 dhe jo të periudhës që po merrej në shqyrtim akreditimi me qëllim argumentimin e standardeve dhe kritereve (konkretisht Standardi IV.1, Kriteri 6. Evidenca 34. Lista e stafit akademik të brendshëm, e të tjera si kjo që nuk ishin vizione dhe misione të përgjithshme, por kritere konkrete për stafin). Po ashtu, konkretisht Ev.3. Rregullore e Programit të Studimit Shkenca Politike – Shkurtimi EV=Evidenca, ndryshe nga RVB është për të dalluar dy dokumente te ndryshme me të njëjtin numër që janë hedhur në platformën online të ASCAL. Pas vizitës në institucion nga GVJ, u kërkua që dokumentacioni të përditësohej dhe saktësohej, mbi bazën e të cilit u bë edhe vlerësimi i përmbushjes së standardeve dhe kritereve të kërkuara në RVJ.



## SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT


### I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr., datë janë:

Programi Bachelor në Shkenca Politike ka marrë akreditimin e fundit sipas Urdhërit nr. 561, datë 30.11.2016 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit "Për akreditimin periodik të Programit të Studimit të Ciklit të parë Bachelor në Shkenca Politike, në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike të SHLUJ Universiteti Marin Barleti, sot ofrohet nga Departamenti i Qeverisjes, Shkenca Politike dhe Komunikim në Fakultetin e Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë.

### II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Përmbushja e standardeve mbi të cilat është dhënë akreditimi i mëparshëm, referuar rekomandimeve të mëposhtme është si vijon.

1. Mbingarkesa mësimore e stafit akademik duket se është në ulje, ndonëse gjithë stafi akademik efektiv është mbi normat standarde, 360 orë në auditor (Evidenca 20.), e sanksionuar kjo ngarkesë në rregulloret e UniBa.  
Plotësohet kriteri që stafi akademik efektiv të ofrojë jo më tepër sesa tre module në semestër, me kushtin jo më tepër se dy module për të njëjtin grup studentësh, që realizohet me shrirjen horizontale të mësimdhënies së një lende në disa degë studimi.
2. Literatura elektronike për programin e studimit sigurohet përmes platformave online që ishin lehtësisht të aksesueshme si nga stafi akademik edhe studentët. Mbetet për t'u pasuruar fondi i librave fizike në bibliotekën e UniBa me literaturat bashkëkohore në fushën e shkencave politike, të cilat të reflektohen edhe në syllabuset e lendëve.
3. Rekomandimi i tretë lidhet me përmirësimin e formave të kontrollit të njohurive për vlerësimin e studentëve të cilat duken të larmishme referuar syllabuseve dhe diskutimeve me stafin akademik të Departamentit.
4. Të përmirësohet shpërndarja e krediteve dhe orëve brenda disa moduleve, duket e përmirësuar, ndonëse ky mbetet një proces që lidhet edhe me orientimet e reja të programit të studimit.



# Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca Politike”

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike” ofrohet në shërbim të interesave kombëtare. Misioni dhe vizioni i UniBa shprehet qartë në Statut përkatësisht në nenin 4 dhe 5 duke dëshmuar se programi i studimit është në përputhje me interesat kombëtare të vendit. Programit në përmbajtjen e tij bazohet në modele profesionalizmi dhe qytetarie nëpërmjet edukimit ndërdisiplinor. Programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk bie ndesh me interesat dhe vlerat kulturore të vendit. (Evidenca 1. Statuti i Universitetit Barleti)
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Bachelor “Shkenca Politike” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Institucioni e realizon aktivitetin bazuar në respektimin e lirisë akademike në procesin mësimor, kërkimor dhe inovativ (Neni 3 Statutit). Filozofia e institucionit vendos “Studentin në qendër” (Shtylla e dytë nga 5 të tilla që ka UniBa), duke kombinuar eksperiencën aktive në praktike profesionale dhe kërkim shkencor. Ky program studimi është në përputhje me qëllimin dhe misionin e universitetit Barleti të parashtruar në dokumente të tilla si: Statuti i Universitetit Barleti, Rregullore e Universitetit Barleti si dhe në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2020-2023. (Evidenca 1. Statuti UniBa; Evidenca 2. Rregullore e UniBa; Evidenca 3. Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2020-2023)
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Programi i studimit Bachelor “Shkenca Politike” është i ndërtuar në përmbushje të objektivave për formimin akademik të studentëve bazuar në njohuritë bashkëkohore dhe praktikën e mira në këtë fushë në përputhje me kontekstin e zhvillimit të shoqërisë shqiptare dhe më gjërë. Në nenin 3, të Rregullores së Programit përcaktohen objektivat e programit si vijon: a) Të pajisë studentët me një formim akademik bazë të përqëndruar në njohuritë dhe kompetencat kyçe të domosdoshme për të përdorur për karrierë profesionale në fushën e shkencave politike. b) Të pajisë studentët me njohuri plotësuese në drejtime të veçanta përmes lëndëve me zgjedhje. c) Tu mundësojë studentëve përvetësimin e njohurive teorike dhe empirike mbi mënyrat dhe metodat e sjelljes politike, qeverisëse dhe organizative. d) Nëpërmjet kërkimit të zhvillohet dija dhe të përmirësohet praktika. e) Të integrojë mësimdhënien, kërkimin dhe shërbimet në mënyrë të tillë që të pasurojnë përvojën e të nxënësit. (Ev 3. Rregullore e Programit )
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	UniBa është institucion jopublik i cili prej 16 vitesh ushtron aktivitetin në fushën e arsimit të lartë. Ky institucion ka në përbërje katër fakultete. Programi bachelor në “Shkenca Politike” ofrohet nga Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë. Staf i nivel fakulteti për vitin 2020-2021 është përbërë nga 22 staf PAE dhe 26 PAK, për vitin 2021-2022 është përbërë nga 30 staf PAE dhe 29 PAK. Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit nga viti 2019 e në vijim është

	<p>përbërë nga 7 anëtar, staf PAE. Përsa i përketë titujve dhe gradave të stafit të brëndëshëm të Departamentit përgjatë viteve 2019-2022 ka patur 1 Prof.Asoc, 2 DR dhe 4 MSC, përgjatë vitin 2022-2023 3 DR dhe 4 MSC. (Ev 30. Anex tabeklat përmbledhëse). Në të ardhmen rekomandohet që stafi i departamentit të realizohet më tituj dhe grada më të larta në mënyrë që të ofrohet një standard më i lartë akademik.</p> <p>Gjithashtu duke u mbështetur në dokumentin “Mendimi i Dekanit” theksojmë se “Ky program është ndër programet e para të licensuar në UniBa dhe i është nënshtruar procedurës së akreditimit dy herë, gjë që dëshmon qëndrueshmëri dhe konsolidimin e përvojës”. (Ev 0. Mendimi i Dekanit)</p>		
<p><b>Kriteri 5.</b>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi bachelor në “Shkenca Politike” ofrohet nga Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë. Ky program ka përputhje të plotë midis fushër së përgjithshme dhe specifike të programit të studimit. Programi klasifikohet në nivelin 6 të kornizës kombëtare të kualifikimeve. Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit, sistemit evropian të transferimit të krediteve dhe në harmoni me kuadrin ligjor vendas. (Ev 0. Mendimi i Dekanit)</p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Përsa referuar më lart, institucioni i arsimit të lartë, i cili ofron programin e studimit bachelor në “Shkenca Politike”, përmbushur plotësisht kriteret e vlerësimit dhe synon ruajtjen e interesave kombëtare, akteve ligjore dhe nënligjore, etj. Në dokumentat ligjor institucional, janë të shprehura qartë misioni dhe vizioni i institucionit për programe studimi aplikative dhe inovatore.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

**Standardi I.2**

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Programi Bachelor në Shkëncë Politike është hapur për herë të parë me shkresë MA Sh 2365 Prot., datë 12.04.2006 ne vitin akademik 2006-2007, me synimin për të patur një qasje konkurruesdhe në plotësimin e kërkesave të tregut. Statuti dhe Rregullorja e institucionit dhe aktet e brendshme dispijnojnë institucionalisht marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda tij, duke përcaktuar rolet e përgjegjësitë përkatëse të drejtuesit të njësisë, përgjegjësit të grupit mësimor apo koordinatorit të programit (Evidenca 1. Statuti i Universitetit Barleti; Evidencë 2. Rregullorja e Universitetit Barleti). Pësha kryesore për realizimin mbahet nga njësia bazë që është Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit si përgjegjes per kete program studimi por edhe njesite e tjera përgjegjese për cilësinë, karrierën apo etiken. Departamenti ka hartuar dhe rregullore per këtë program studimi (Ev 3. Rregullore programi). Përveç përgjegjësit të departamentit përmes Urdhërit nr.111datë 20.12.2019 dhe më pas me Vendimit nr. 31 dt.14.10.2022 është caktuar dhe koordinorja e programit të studimit të cilët kontribuojnë në ecurinë dhe zhvillimin e kurrikulës së programit të studimit (Ev 3.1 Koordinatori i dept). Institucioni ka përcaktuar dhe është e qartë ndarja e detyrave dhe përgjegjësiwe në</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.		
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	<p>Institucioni është i fokusuar dhe ka një politikë të hapur ndaj bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar. UniBa ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me partnerë vendas dhe të huaj, të cilat luajnë rol të rëndësishëm në permbushjen e objektivave të programit të studimit (Ev 10.2 Marrëveshje bashkëpunimi).</p> <p>Nëpërmjet marrëveshjeve të partneritetit dhe memorandumëve të bashkëpunimit me institucione publike dhe private UniBa mundëson realizimin e praktikave profesionale të studentëve, angazhimin vullnetar të studentëve në komunitet, vizita studimore, si edhe aktivitete të përbashkëta.</p> <p>Marrëveshjet me IAL të ndryshme ndërkombëtare dhe pjesëmarrja në projektet Erasmus+, sipas referencave të mësipërme, kanë krijuar mundësi shkëmbimi për pedagogët dhe studentët që ndjekin programin Bachelor në Shkenca Politike.</p>		
<b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	<p>Institucioni ka marrëveshje me institucione publike dhe jopublike që ndihmojnë studentët për kryerjen e praktikës. Këto marrëdhënie janë të rëndësishme për zhvillimin dhe zbatimin e praktikës. Sipas dokumentacionit të shqyrtuar, më konkretisht Evidenca 22 “Politika e bashkëpunimit dhe marrëveshjet e partneritetit në funksion të programit” rezultojnë se përfitimet që merren nga realizimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit lidhen me mundësitë e ofruara për realizimin e praktikës mësimore për realizimin e objektivave dhe aftësimin profesional të studentëve, mundësitë e punësimit të studentëve, organizimin e aktiviteteve të përbashkëta si leksione, forume, seminare etj (Ev 22 Politika bashk. dhe marrëveshjet, fq.2). Gjithashtu institucioni ka hartuar dokumente që rregullon procedurën e organizimit të praktikës. Paketa e Praktikës përmban procedurat që duhet të ndiqen dhe rolin e aktoreve dhe njësisve të ndryshme të përfshira në këtë proces. Ky dokument përshkruan marrëdhënien me institucionet ku studentet kryejnë praktikën, procedurat si dhe në mënyrë të detajuar formatet e raportimit dhe të vlerësimit për këtë proces, ku janë përcaktuar qëllimet dhe aftësitë e synuara, detyrimet e studentit, pedagogëve supervizues dhe institucioneve pritëse. (Ev 2.2 Paketa e praktikës Bch)</p>		
<b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimëve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<p>Sipas dokumentacionit të shqyrtuar, UniBa ka marrëveshje zyrtare me një sërë aktorësh e institucione për kryerjen e praktikave, në përputhje me natyrën specifike të programit. Bazuar në dokumentin “Analizë vjetore e departamentit për vitin akademik 2020-2021” rezultojnë se në funksion të praktikës studentore janë realizuar bashkëpunime të reja si me Bashkinë Shkoder, Mat, Elbasan, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Institutin për bashkëpunim dhe Zhvillim. (Ev 22.1 Analizë e dept 20-21. Fq.3) Institucioni ka një procedurë të miratuar ku detajohet procesi i realizimit dhe mbikëqyrjes së praktikës mësimore (Ev 2.2 Paketa e praktikës Bch). Nga raporti rezultojnë se përfitimet që merren nga realizimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit lidhen me trajnimet e ndryshme, leksionet e hapura, konsulencat e vazhdueshme midis paleve për realizimin e objektivave dhe aftësimin profesional të studentëve, mundësitë e punësimit të studentëve, etj (Ev 22 Politika bashk. dhe marrëveshjet).</p>		
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ, bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet në institucion konkludon se institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit. Institucioni dhe njësia bazë ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunuese në kuadër të realizimit të kërkesave që ka programi i studimit për realizimin e praktikës mësimore etj. Përbushet plotësisht.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>



				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Pas shqyrtimit dokumentacionit që qendet në Evidencë 2 e cila përmban planin mësimor të programit të studimit Bachelor në Shkëncë Politike, si dhe takimeve të realizuara gjatë vizitës në UniBa konkludojmë se programi është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me udhëzimet e MAS, me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Kategorizimi i lëndëve është sipas kategorive A-E, dhe kreditet janë të vendosura në përputhje me përqindjen e parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Totali i krediteve të përfituara në përfundim të studimeve është 180 ECTS. (Ev 2 Dosja e programit)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor Shkëncë Politike ofron njohuri themelore teorike dhe praktike, ku ndërthuren njohuritë e përgjithshme, të përcaktuara në kategorinë A, me njohuritë specifike të lidhura me fushën e studimit, të përcaktuara në kategorinë B si dhe ndërdisiplinore dhe plotësuese me lëndët e kategorisë C dhe D. Ndërthurja e komponentëve teorik me ato praktik, mundëson pajisjen e studentëve me aftësi për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në fushën e shkencave politike. Formimi i studentet me aftësi profesionale në Shkëncë Politike synohet si në aspektin teorik ashtu edhe atë praktik, nëpërmjet lëndëve të tilla si: Elementët e të drejtës publike; Sociologji, Mendim ekonomik etj realizohet një formim bazë dhe le lëndë të tilla si: Hyrje në Shkëncë Politike; Qeverisje e Krahastuar; Metodat e Analizës Politike; Të Drejtat e Njeriut etj synohet një formim më i profilizuar. Gjithashtu lëndët me zgjedhje si dhe praktika realizojnë një gërshetim të njohuriv specifike në funksion të zhvillimeve ekonomike apo/dhe shoqërore, por edhe të tregut të punës. (Ev 2 Dosja e programit) Përfshirja e studentëve në aktivitete ekstrakurrikulare të UniBa pasuron ofertën e formimit profesional të programit për studentët. (Ev 22.1 Analize e dept 20-21; Ev 3 Rregullore programi)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Kurrikula e këtij programi me lëndët përbërëse është organizuar sipas kategorive (A-E), në përputhje me Shtojcën I të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Per elementitit e programeve të studimit të ofruara nga IAL."</p> <p>Në planin mësimor të programit të studimit, janë përcaktuar kreditet për cdo kategori nga A-E. Në mënyrë specifike, në këtë program ofrohen:</p> <p>Për lëndët e Kategorisë A 36 kredite;  Për lëndët e Kategorisë B 98 kredite  Për lëndët e Kategorisë C 24 kredite  Për lëndët plotësuese të Kategorisë D 16 kredite, dhe 6 kredite janë detyrimet përmblyese (E).</p> <p>Ngarkesa për një vit akademik është 60 kredite në vit, perkatesisht 30 ECTS për semester. Totali i krediteve për modulet e kategorisë A dhe modulet e kategorisë E është 180 ECTS</p> <p>Syllabuset respektojnë standartet e shpërndarjes së krediteve: 1 kredit = 25 ore mesimore në auditor, ku përfshihen aktivitete të tilla si leksione, seminare, ushtrime,</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës, si dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit. (Ev 2 Dosja e programit; Ev 30 Anex Tabelat permbledhese. Tabela 9, fq.8)		
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Në planin mësimor të programit të studimit, janë përcaktuar kreditet për praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse, të cilat ndodhen respektivisht: Praktika në kategorinë D dhe ka 4 ECTS ndërsa detyrime përmbyllëse në kategorinë E dhe ka 6 ECTS. Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve dy dokumente të rëndësishme në lidhje me këto detyrime. Së pari studenti pajiset me “Paketën e praktikës për programin bachelor” të cilën ata duhet ta plotësojnë dhe dorëzojnë në departament përpara detyrimeve përmbyllëse. Gjithashtu në lidhje me këtë të fundit departamenti ka hartuar programin e provimit të formimit të cilin edhe atë ua vë në dispozicion studentëve për t’i orientuar për provimin final. (Ev 30 Anex Tabelat permbledhese. Tabela 9, fq.8; Ev 2.2 Paketa e praktikës Bch; Ev 2.1 Programi i prov. Formimit)		
<b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimit të studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Programi i studimit bachelor në Shkenca Politike është i organizuar në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe aktet nënligjore respektive. Bazuar në RVB dhe dokumentin evidencën 18 dhe 19 “Politika e pranimit të studentëve..” institucioni ndër të tjera ka përcaktuar në pikën 3.1 “Procesi i aplikimit nga maturantët/kandidatët” procedurën dhe kriteret për pranim në këtë institucion sipas udhëzimeve të MAS. (Ev 18-19 Politika e pranimit. Fq.6-7)		
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Nuk aplikohet në rastin e këtij program studimi		
<b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Në planin mësimor është paraqitur çdo lëndë me kodin përkatës sipas aktit regulator të brendshëm, kështu psh lënda “Teknologji Informacioni” ka kodin “INF015”, apo lënda “Mendim Ekonomik” ka kodin “MEK 016”. Institucioni është në pritje të akteve nënligjore përsa i takon realizimit të kodifikimit të programit të studimit. (Ev 2 Dosja e programit; 00 RVB i BSc ne Shkenca politike)		
<b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Nuk aplikohet në rastin e këtij program studimi		
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se programi i studimit është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore. Përmbyllet plotësisht.</i>		
<b>Shkalla e përmbyljes së standardit</b>	<b>Përmbyllet pjesërisht</b>	<b>Përmbyllet kryesisht</b>	<b>Përmbyllet plotësisht</b>
			X

## Standardi II.2

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit është njësia bazë përgjegjëse për realizimin e programit bachelor në Shkenca Politike (neni 3 i dokumentit të titulluar “Rregullore të përgjithshme dhe specifike të funksionimit të njësisë kryesore dhe bazë që ofrojnë programin e studimit” (sqarim: kjo është Evidenca 1 por në sistem është emërtuar si: Ev 1 Rregullore e NjK dhe NjB). Ky departament është një nga tre njësitë e Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë. Departamenti përbëhet nga 7 anëtar personel akademik me kohë të plotë, ku 3 prej tyre mbajnë gradën Doktor Shkencash dhe 4 janë më Master Shkencor. (Ev 34 Lista e stafit akademik 2022-23; Ev 1 Rregullore e NjK dhe NjB, neni 3). Për organizimin e punës krahas akteve në nivel institucional, departamenti ka miratuar dhe një rregullore të dedikuar për programin e studimit bachelor “Shkenca Politike”. Në këtë dokument janë të përcaktuara objektivat e programit, mënyra e organizimit të studimeve, politika e frekuentimit, plani mësimor etj. (Ev 3 Rregullore program). Departamenti drejtohet nga Përgjegjësi ndërsa puna në departament koordinohet nga Koordinatori i Departamentit. (Ev 3.1 Koordinatori i dept; Ev 1 Rregullore e NjK dhe NjB). Ky departament përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën dhe stafet akademike.		
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Programi i studimit bachelor në “Shkenca Politike” ka si pjesë të planit mësimor realizimin e praktikës mësimore në vitin e tretë të studimeve. Nga njohja me dokumentacionin e vënë në dispozicion, dhe vizitën e realizuar në institucion, konstatohet se për realizimin e praktikës mësimore angazhohet koordinatori i programit. Të gjitha procedurat janë të përcaktuara në paketën e praktikës. (00 RVB i BSc ne Shkenca politike; Ev 2.2 Paketa e praktikës Bch)		
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Në dokumentin e titulluar “Rregullore të përgjithshme dhe specifike të funksionimit të njësisë kryesore dhe bazë që ofrojnë programin e studimit” (sqarim: kjo është Evidenca 1 por në sistem është emërtuar si: Ev 1 Rregullore e NjK dhe NjB) është përcaktuar se krahas Përgjegjësit të departamentit puna në departament koordinohet nga Koordinatori i Departamentit. Në bazë të vendimit nr 31 datë 14.10.2022 në pozicionin e Koordinatorit të departamentit të Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit është caktuar Msc Fatjona Qurku. (Ev 3.1 Koordinatori i dept). Detyrat e tij janë të përcaktuara në nenin 6 të rregullores së departamentit, ku janë të specifikuar konkretisht dhe detyrat e tij. Gjatë vizitës në institucion grupi i vlerësimit të jashtëm u takua me koordinatoren e departamentit. Gjithashtu koordinatori është dhe personi përgjegjës për realizimin e praktikës mësimore.		
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konkludon se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi. Përmbushet plotësisht.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Pas shqyrtimit të Dosjes së Vetëvlerësimit të programit të studimit, takimeve gjatë vizitës në UniBa dhe dokumentave shtesë, grupi i ekspertëve të jashtëm thekson se Departamentit të Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit disponon informacionin e nevojshëm lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, të cilat janë të aksesueshme dhe ju vihen në dispozicion stafit akademik, stafit administrativ dhe studentëve që ndjekin këtë program studimi. Programi i studimit është organizuar sipas Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programit të studimit të ofruar nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar dhe rregullores së programit të studimit (Ev 27 Aktet ligjore e nenligjore). GVJ konstatoi se programi i studimit është i organizuar në lëndë, aktivitete formuese dhe praktikë profesionale të vlerësuara me kredite sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS), të cilat zhvillohen në tre vite akademik, të ndarë në dy semestra. (Ev 2 Dosja e programit; Ev 3 Rregullore program). Nga viti 2016 UniBa ka një sistem digital online për çështjet akademike të studentëve. Sistemi ndër të tjera përmban: lëndët, silabuset, materialet e studimit, oraret mësimore etj (Ev 23 Udhëzues përdorimi të TIK. Fq. 4-5)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit bachelor në “Shkenca Politike” është i ndërtuar mbi bazën e planit mësimor, i cili jep informacion të detajuar në lidhje me llojin e veprimtarisë, numrin total të krediteve për cdo lëndë, ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore në auditor dhe orë punë individuale për cdo lëndë të programit. Ndërkohë, në rregulloren e akademike të institucionit si dhe rregulloren e programit të studimit përcaktohen rregullat për frekuentimin e mësimin dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe sistemin e vlerësimit, zhvillimin e provimeve, etj. (Ev 2 Dosja e programit; Ev 3 Rregullore program)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Institucioni posedon një kuadër të plotë rregullator që lidhet me përcaktimin e kriterëve të përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Ato janë të përcaktuara në dokumentat rregullatorë të institucionit UniBa dhe të programit të studimit, në përputhje me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore (Evidenca 2. Rregullorja e Universitetit Barleti). Në dokumentin “Rregullore e brendshme për transferimin dhe regjistrimin në programe të dyta të studentëve në Universitetin barleti” përcaktohen procedurat dhe dokumentacionet që nevojiten në raste të tilla. (Evidenca 35. Rregullore e Brendshme per Transferimet). Gjithashtu institucioni ka dhe një dokument ku përcaktohet politika e pranimit të studenteve (Ev 18-19 Politika e pranimit). Në UniBa nëpërmjet Zyrës së Pranimeve, studentët e UniBa-s, por dhe ata potencialë informohen dhe orientohen në lidhje me kriteret e pranimit dhe mundësitë e transferimit të studimeve dhe/ose të krediteve të fituara gjatë zhvillimit të studimeve.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve që përmban kurrikula e programit të studimit janë hartuar në përputhje me udhëzimet përkatëse dhe janë të strukturuar sipas formatit të miratuar, në nivel institucioni. Në to paraqitet informacion i detajuar në lidhje me objektivat e lëndës, temat për secilën javë, format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar që studenti duhet të lexojë. GVJ në syllabuset e disa lëndëve sugjeron përditësimin e literaturës (qoftë kjo literaturë bazë ose e rekomanduar) duke ofruar libra të publikuar në 5 vitet e fundit. (Ev 2 Dosja e programit)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Institucioni ka hartuar një dokument të titulluar “Manual i hartimit / riorganizimit, mbylljes dhe vlerësimit të programeve të studimit”. Ky dokument përmban praktikën dhe procedurën për rishikimin sipas rastit të programeve të studimit. Sipas akteve nënligjore institucioni ka të drejtë të bëjë ndryshime profilizuese deri në masën 20 % pas akreditimit të programit. Syllabuset përditësohen dhe miratohen para fillimit të çdo semestri. (Evidenca 28. Manuali i Hartimit. Riorganizimit. mbylljes dhe vlerësimit të prog. studimit DHJETOR 2022)</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë të studimit. Përditësimi i literaturës me publikime të 5 viteve të fundit (aty ku është e mundur) do të ishte një pikë plus për procesin e mësim-dhënies.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit për programin e studimit “Shkenca Politike” konstatohet se emërtimi e përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe punësimin e studentëve. Ato janë të organizuara në 5 kategori (A-E), si: lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinare/integruese, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse, me vlerësimin përkatës në orë mësimore e kredite. Kombinimi i komponentëve teorik me ato praktik, vlerësohet i përshtatshëm, duke qenë se në semestrat e parë studentët pajisen me njohuri të formimit të përgjithshëm dhe karakterizues të disiplinës përkatëse, për të vijuar në vitin e fundit me praktikën mësimore dhe detyrimet përmbyllëse. (Ev 2 Dosja e programit; Ev 30 Anex Tabelat permbledhese.fq 8-9)
<b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Vlerësohet se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit (Ev 2 Dosja e programit; Ev 30 Anex Tabelat permbledhese.fq 8-9), mundëson arritjen e objektivave të përgjithshme dhe objektivave specifik të programit të ciklit të parë, Bachelor në “Shkenca Politike” të përcaktuar në Rregulloren e tij. Shpërndarja e lëndëve realizohet përkatësisht në 6 semestra të shtrira përgjatë 3 viteve akademike, me kreditet e orët mësimore përkatëse, përputhet me përcaktimet ligjore në fuqi dhe është në funksion të objektivave formues të programit e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin të studentëve.
<b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raportit teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, lëndët dhe ngarkesa e tyre, është në përputhje me një program studimi të ciklit të parë në fushën e shkencave politike (Ev 2 Dosja e programit; Ev 30 Anex Tabelat permbledhese.fq 8-9), dhe përmban lëndë të përgjithshme dhe karakterizuese të përafërt me programe të ngjashme (kryesisht lëndët teorike), por ka dhe risi për sa i takon lëndëve që përfshihen në vitin e tretë.
<b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Organizimi i programit të studimit, sikurse dhe përmbajtja e tij, mundësojnë arritjen e objektivave formues (Ev 3 Rregullore programi. ; Ev 2 Dosja e programit; Ev 30 Anex Tabelat permbledhese.fq 8-9), transferimin e studimeve dhe mobilitetin e studentëve, sikurse dhe punësimin e studentëve pas përfundimit të studimeve duke qenë se programi i pajis me njohuri dhe kompetenca të përshtatshme. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik në përfundim të studimeve i shërben arritjes së objektivave të zhvillimit profesional dhe aftësimin për tregun e punës. Lidhur me mobilitetin e studentëve, numri i tyre ka qenë i pakët vetëm 1 student përgjatë vitit akademik 2020-2021 (Evidenca 14. Te dhena mobilitetin, fq. 5). Bazuar në raportin e departamentit ky vit akademik është realizuar tërësisht online si pasojë e

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	pandemisë. (Ev 22.1 Analize e dept 20-21 fq.2)		
<b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	GVJ konstaton se syllabuset e të gjitha lëndëve në këtë program studimi janë në përputhje me vendimet ligjore duke filluar me pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura dhe në fund vërejtje përfundimtare nga pedagogu. Në parim, funksionon që në fillim të çdo viti akademik pedagogëve u kërkohet përditësimi i syllabuseve. Referuar literaturës së detyruar apo ndihmëse vendase dhe të huaj ka nevojë që në disa lëndë të azhrohohet aty ku është e mundur me literaturë të 5 viteve të fundit me profilin specifik lëndor. (Ev 2 Dosja e programit)		
<b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit të studimit garanton dhe është në përputhje të plotë me përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe të shprehura qartë në qëllimet dhe objektivat e secilës lëndë të këtij programi (sipas Kategorive A-E, raporti midis komponentëve teorik dhe atyre praktik). Fokusi i studimit të programit bachelor në “Shkenca Politike” është marrja e njohurive të thelluara në këtë fushë dhe përmbajtja e programit ofron fitimin e njohurive dhe kompetencave të synuara. (0 Mendimi i Dekanit)		
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.	Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike”, mundëson vijimin e studimeve në programe të ciklit të dytë, sikurse dhe mundësinë e punësimit të të diplomuarve në këtë program studimi. Lëndët e këtij programi studimi, i pajisin studentët jo vetëm me njohuri të përgjithshme, por edhe me njohuri të specializuara në disiplinën e shkencave politike, por edhe me aftësi për kërkimin shkencor, një element i rëndësishëm kryesisht për studentët që synojnë vijimin e programeve Master i Shkencave apo edhe avancime të mëtejshme. (Ev 2 Dosja e programit)		
<b>Konkluzione</b>	GVJ konkludon se struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

### Standardi II.5

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Gjatë vizitës në institucion, nga drejtuesi i njësisë kryesore dhe asaj bazë, GVJ u informua mbi përpjekjet e institucionit për të riorganizuar këtë program studimi në përshtatje të nevojave dhe kushteve të reja të tregut të punës. Në minutat e takimit thuhet se “Ky program është mbyllur sipas urdhërit të MAS nga data 1 shkurt 2023...riorganizimi me fushën politike, ekonomike më shumë administratë... Ndryshimet do të realizohen në masën 20%.”(Dokumentacioni shtesë: shenime gjate vizites UBarleti). Departamenti për realizimin e përmirësimit të përmbajtjes së programit dhe përshtatjen e tij me kërkesat e tregut të punës ndihmohet dhe nga strukturat përgjegjëse të cilat konsultohen me propozimet që vijnë nga institucionet partnere dhe bordi i karrierës. (00 RVB i BSc ne Shkenca politike; Ev 36 Bordi i Karrieres ne Dept)
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe	UniBa ka si moto të tij “Studenti në qendër” duke reflektuar më së miri atë çka studentët përfaqësojnë për Institucionin (Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafra», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

<p>strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>institucional 2020-2030). Departamenti realizon një punë përfshirëse me studentët përmes takimeve periodike me ta. Studentët janë të përfshirë në diskutime që në momentin e hartimit të programit dhe departamenti mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. Dhe gjatë takimin me studentët na u konfirmua përfshirja dhe komunikimi I afërt që ata kishin me stafin dhe drejtuesit e departamentit. (00 RVB i BSc në Shkenca politike; Ev 22.1 Analize e dept 20-21 fq.3; shenime gjate vizites UBarleti fq.4)</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit si njësi përgjegjëse për organizimin dhe mbarëvajtjen e këtij program studimi disponon dokumentacion dhe mban marrëdhënie me institucionet partnere dhe rrjete profesionistësh që operojnë në institucionet e vendit. Mendimet dhe sugjerimet e tyre janë të rëndësishme në hartimin e programit dhe merren në konsideratë në rast të përditësimit dhe përshtatjes së programit. (00 RVB i BSc në Shkenca politike; shenime gjate vizites UBarleti)</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konkludon se institucioni nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre. Strukturat drejtuese në nivel njësie kryesore dhe bazë e vlerësojnë bashkëpunimin me institucionet partnere në funksion të përmirësimit të programit të studimit. Përbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p> <p>X</p>

<p><b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p> <p>X</p>
--	------------------------------------	------------------------------------	-----------------------------------	---

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT


<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>GVJ, pas shqyrtimit të dosjes së Vetëvlerësimit të programit të studimit si dhe takimeve gjatë vizitës në IAL duke iu referuar edhe planit mësimor, format e përdorura të mësimdhënies janë: leksionet, seminarët, projektet/ detyrat e kursit, praktika dhe udhëzimet për provimin e përgjithshëm përfundimtar/ diplomën.</p> <p>Ndarja e tyre është si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Leksione – 850 orë mësimore</li> <li>2. Seminare – 394 orë mësimore</li> <li>3. Projekte/detyra kursi – 28.5 orë mësimore</li> <li>4. Praktika – 90 orë mësimore</li> </ol> <p>Provë finale – 30 orë mësimore</p> <p>Programi i lëndës jep informacion mbi titullarin e lëndës, ngarkesën (në ECTS dhe orë mësimore), vitin akademik/ semestrin kur zhvillohet, kategorinë dhe llojin e lëndës, kontaktet e titullarit; përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit; konceptet themelore; temat e lëndës dhe metodat pedagogjike për seminarin/laboratorin; format e kontrollit të dijeve; literaturën bazë të detyrueshme dhe literaturën e rekomanduar; vërejtje përfundimtare nga pedagogu i lëndës. (Ev 2 Dosja e programit) Institucioni ka hartuar një dokument të titulluar “Politika për të mësuarit, mësimdhënien dhe cilësinë në mësimdhënie” i cili shërben për të orientuar stafin akademik në procesin e letrimit dhe jo vetëm. (Ev 11 Politika për të mësuarit).</p> <p>Format e kontrollit të dijeve të studentëve realizohet bazuar në komponentë të tillë si provimet, pjesëmarrja dhe aktivizimi i studentit në orët mësimore, realizimi dhe prezantimi i detyrave të kursit, mbyllja e detyrimeve të praktikës profesionale, dhe detyrimet përmblyëse.</p> <p>Çdo syllabus ka të përcaktuar format e vlerësimit të studentëve. Vlerësimi përfundimtar merr në konsideratë të gjithë përbërësit e vlerësimit të studentëve dhe rezultatit e provimit përfundimtar sipas kriterëve të vlerësimit të kursit. Gjithashtu institucioni organizon “Javën e Orientimit”, ku me fillimin e vitit akademik, gjatë javës së parë të tij, Zyra e Dekanit të Studentëve vë në dispozicion manualin orientues për studentët me të drejtat, detyrat e tyre, organizimin institucional, programin e studimit, ambientet, stafin akademik dhe ndihmës akademik, etj. (Ev 29.1 Agjenda e diteve të akomodimit)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe takimet e realizuara me stafin akademik dhe studentë të këtij programi studimi u konstatua se stafi është në kontakt të vazhdueshëm me studentët e tij dhe ka zhvilluar forma ndërveprimi me ta (shenime gjate vizites UBarleti), duke nxjerrë në pah aftësitë dhe cilësitë e gjithsecilit student, pa kursyer burimet e veta në dispozicion të diversitetit të studentëve, por, njëkohësisht, duke ruajtur edhe natyrën e veprimtarive formuese që ky program studimi ofron. Larmishmëria e metodave të mësimdhënies e përcaktuar tek “Udhëzuesi i për Mësimdhënien...” (Ev 11 Politika për të mësuarit) dhe infrastruktura teknologjike me të cilën janë të pajisura sallat e leksionit mundësojnë aplikimin e përdorimit të videove ilustruese, prezantimeve në ppt etj nga ana e stafit dhe studentëve gjithashtu.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në</p>	<p>UniBa ka një politikë mbështetëse për personelin e tij akademik me asistencë logjistike (kompjuter dhe pajisje të tjera plotësuese), me trajnime informuese mbi përdorimin e teknologjisë së informacionit. Struktura brenda universitetit asistojnë</p>



përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	stafin me udhëzues dhe manuale përsa i takon politikave të mësimdhënies por edhe përdorimit të teknologjisë. Këto trajnime kanë lehtësuar ndjeshëm përdorimin e formave të reja didaktike në shërbim të mësimnxënies dhe në arritjen e objektivave formues. (Evidenca 44. Udhëzues për përdorimin e Strukturës së TIK; Ev 11.3 Manuali e mesimdh. Online; Ev 11 Politika per te mesuarit; Ev 11.3 Manuali e mesimdh. Online; Aneks 1. Manuali i perdorimit te google classroom pedagogu)			
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të personeli akademik efektiv rezultojn se stafi është plotësisht përgjegjës në lëmin e vet shkencor, duke qenë se është personeli i formuar në institucionet arsimore më në zë vendase dhe të huaja dhe arrin ti përcjellë dijet me përgjegjësi shkencore te brezi i ri nëpërmjet metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies. Gjithashtu institucioni ka dhe një politikë të zhvillimit shumë dimensional të stafit akademik. (Ev 8 Politika e Zhvillimit te Stafit) Lektorët si dhe asistentë lektorë, përdorin metoda bashkëkohore ku ndërthurin pjesën e teknologjisë në mësimdhënie. GVJ sugjeron plotësimin e stafit me tituj dhe grada duke qenë se 4 prej tyre mbajnë gradën MSC.			
<b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Njësia bazë, pra departamenti realizon monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës-akademik. Vlerësimi bëhet nëpërmjet vlerësimit peer to peer mes kolegëve, pytesorëve të studentëve që hartohet nga Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe të Cilësisë, si dhe vlerësimet vjetore që bëhen nga përgjegjësi I njësive bazë. (Ev 11.2 Raporti vleresimit te studenteve; Ev 11.7 Raportim i NJZHKC-mesimdhënia; Ev 11.1.1 Formular i punes semestrale; Ev 11.1. Instrumentat e vleresimit; Ev 11.2 Raporti vleresimit te studenteve)			
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Në statutin e universitetit janë përcaktuar struktura të cilat realizojnë monitorimin për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor. Në nenin 28 të Statutit përcaktohet Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë (KSSC) i cili është një komision i përhershëm i cili siguron orientim, këshillim, dhe mbështetje në hartimin e politikave të të procedurave të sigurimit të brendëshëm të cilësisë. KSSC mbështet Njësia e Zhvillimit Kurrikularë dhe të Cilësisë për të përmbushur funksionet e saj lidhur me garantimin e përmbushjes së standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit. (Evidenca 1. Statuti i Universitetit Barleti, fq.12; Evidenca 17. Politika per te mesuari, mesimdhënien dhe cilesin ne mesimdhënie) UniBa organizon në mënyrë periodike trajnime me stafin akademik, kryesisht për metodat e reja dhe inovative në fushën e mësimdhënies. Universiteti Barleti disponon manualin mbi procedurat e mësimdhënies dhe përdorimin e metodave të ndryshme për një mësimdhënie bashkëkohore, ai nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies referuar rezultateve të nxjerra nga proceset monitorim-vlerësim dhe vetëvlerësimi i vetë pedagogut. (Ev 11 Politika per te mesuarit)			
<b>Konkluzione</b>	<i>Në pëmbjllje të këtij standardi, GVJ konkludon se institucioni ka garantuar procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. Përmbushet plotësisht</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

**Standardi III.2****Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit në kreun III, neni 17 përcaktohen kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të dijeve dhe njohurive profesionale.( Ev 3 Rregullore program, fq.7). Gjithashtu ne nivel universiteti është Rregullorja e institucionit që përcakton procesin e testimit dhe vlerësimit të njohurive në kreun VII, neni 88 “Forma e kontrollit”. (Evidenca 2. RREGULLORJA E UNIVERSITETIT BARLETI, fq.38) Çdo fillim viti akademik studentët informohen nëpërmjet përgjegjësit dhe koordinatorit të departamentit mbi rregulloren e programit dhe jepen shpjegimet e duhura për çdo rast. Institucioni ka procedura transparente të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit përse i përket vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Mënyra e kontrollit të dijeve është e përcaktuar dhe në syllabusin e çdo lënde. (Ev 2 Dosja e programit)</p>												
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit bachelor në “Shkenca Politike” i njeh studentët në fillim të semestrit me syllabusin, ku theksohet mënyra e kontrollit dhe format e vlerësimit të dijeve, së bashku me afatet për secilin detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës. Gjatë vizitës në institucion dhe takimeve me stafin akademik dhe studentët u konfirmua ky proces. Studentët informohen në detaje për mënyrën e vlerësimit të njohurive të tyre. Në syllabus ka një seksion të titulluar “Kontrolli i vazhdueshëm” ku janë të specifikuar sipas komponentëve testimi i njohurive dhe dijeve si në tabelën vijuese:</p> <table border="1" data-bbox="592 958 1289 1144"> <thead> <tr> <th>Komponentët e vlerësimit</th> <th>Pesha (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Provimi i ndërmjetëm</td> <td>20</td> </tr> <tr> <td>Pjesëmarrja dhe aktivizimi</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>Detyra e kursit<sup>1</sup></td> <td>20</td> </tr> <tr> <td>Provimi përfundimtar</td> <td>50</td> </tr> <tr> <td><b>TOTALI</b></td> <td><b>100</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>(Ev 2 Dosja e programit)</p>	Komponentët e vlerësimit	Pesha (%)	Provimi i ndërmjetëm	20	Pjesëmarrja dhe aktivizimi	10	Detyra e kursit <sup>1</sup>	20	Provimi përfundimtar	50	<b>TOTALI</b>	<b>100</b>
Komponentët e vlerësimit	Pesha (%)												
Provimi i ndërmjetëm	20												
Pjesëmarrja dhe aktivizimi	10												
Detyra e kursit <sup>1</sup>	20												
Provimi përfundimtar	50												
<b>TOTALI</b>	<b>100</b>												
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të studentit bëhet gjatë gjithë kohës së zhvillimit të lëndës, si nëpërmjet vlerësimit formues ose të vazhduar dhe atij përmbledhës. Në format e vlerësimit të vazhduar përfshihen, vlerësim për përgjigjet në seminare, aktivizimi, provim me shkrim, me detyra kursi, projekte, ese. Detyra e kursit mund të jetë: ese, punë në grup, rast studimor, projekt, prezantim, performancë sportive ose artistike, etj. Ajo përcaktohet nga titullari, në varësi të specifikave të lëndës. Pedagogu i lëndës i vë në dispozicion studentëve strukturën e detyrës së kursit, duke e orientuar secilin student për tematikën e zgjedhur. Periudha e zhvillimit të provimit të ndërmjetëm, dhe periudha e zhvillimit dhe/ose dorëzimit të detyrës së kursit, vendosen në javën/t përkatëse në syllabus. Provimi i ndërmjetëm, në varësi të specifikave të lëndës/modulit, zhvillohet në javën e gjashtë ose të shtatë, dhe kontrollon njohuritë e temave të zhvilluara në pesë javët e para. Provimi i ndërmjetëm zhvillohet në orën e seminarit/praktikës së javës përkatëse. Vlerësimi përmbledhës realizohet me test përmbledhës në fund të vitit akademik. (Ev 26 Model teze provimi lende). Zhvillimi i provimit përfundimtar është i detyrueshëm, pavarësisht sasisë së pikëve të grumbulluara nga komponentët e tjerë të vlerësimit. (Ev 2 Dosja e programit, syllabuset).</p>												
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson</p>	<p>Institucioni ka strukturat administrative dhe instrumentat në lidhje me marrjen e feedback-ut nga studentët për realizimin e procesit mësimor. Në nivel institucional,</p>												



format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe të Cilësisë realizon plotësimin e pyetësorëve drejtuar studentëve mbi aspekte të ndryshme të mësim-dhënies si: Organizimi i lëndës; Përbajtja e lëndës; Materialet e lëndës; Komponentët e vlerësimit dhe aspektet pedagogjike të lektorit (Ev 11.1. Instrumentat e vlerësimit). Pyetësorët realizohen për çdo lëndë dhe pedagog në përfundim të semestrit. Në përfundim të këtij procesi hartohet dhe një raport me gjetjet e procesit të vlerësimit. (Ev 11.2 Raporti vlerësimit të studenteve). Ky proces është i rëndësishëm pasi vlerësimet e studentëve konsiderohen për përmirësimin e metodave dhe formave të mësimdhënies në mënyrë periodike.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Universiteti Barleti ka investuar në një infrastrukturë teknologjike duke krijuar stafit akademik mundësi për përdorimin e metodave të shumëllojshme teknologjike, didaktike dhe pedagogjike. Stafëve u vihen në dispozicion udhëzues dhe manuale përsa i takon politikave të mësimdhënies dhe përdorimit të teknologjisë. Bazuar në strukturën e “kontrollit të vazhdueshëm” pjesë e silabuseve vërehet se format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit përmes punës individuale që ai realizon në kuadër të çdo lënde. (Ev 2 Dosja e programit, syllabuset)			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konkludon se institucioni ka përcaktuar në aktet e tij rregullatore (që nga Rregullorja e Universitetit deri tek rregullorja e programit të studimit) procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre. Këto komponent janë pjesë e çdo syllabusi gjithashtu. GVJ shpreh vlerësimin: Përbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	
			X	

### Standardi III.3

**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Stafi akademik mbështetet në përfundimet e kontrollit të vazhdueshëm si dhe në frekuentimin dhe pjesëmarrjen aktive në leksione, seminare, praktika, punë krijuese, punime të ndryshme dhe detyra kursi për realizimin e procesit të vlerësimit të dijes së studentit. Vlerësimi përfundimtar i njohurive është bashkimi i vlerësimit të vazhdueshëm me vlerësimin përmbledhës, që realizohet me anë të provimit në fund të realizimit të programit mësimor të kursit. Mbështetur në syllabuset e lëndëve, vlerësimi i studentëve bëhet përgjatë gjithë kohës së zhvillimit të kursit në mënyrë të vazhdueshme. Kështu, vlerësimi realizohet përmes provimit të ndërmjetëm (20 %), pjesëmarrja dhe aktivizimi në seminare (10 %), detyrës së kursit (20 %) si edhe përmes

	provimit final (50 %). (Ev 2 Dosja e programit, syllabuset)												
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Gjatë periudhës së Pandemisë dhe në vijim, Institucioni ka përdorur platforma dhe sisteme online si “Portali Studentor” (Aneks 5. Portali studentor) apo “Google Classroom” (Ev 11.7.2 Databaza e kodeve ne classroom) etj për realizimin e vlerësimit elektronik. UniBa krahas vlerësimit “paper based test” dhe vlerësimit me gojë zbaton edhe vlerësim elektronik, që nënkupton hartimin, postimin dhe prezantimin/mbrojtjen e detyrës/projektit të kursit. (Ev 23 Udhëzues përdorimi te TIK)												
<b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	<p>Procedura e vlerësimit përfundimtar mbështet në rregulloret e UniBa. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me kategorizimet e komponentëve të vlerësimit që ka syllabusi. Provimi zhvillohet në praninë e dy pedagogëve, ku njëri është titullar dhe tjetri asistent. Në nenin 88 të Rregullores së universitetit thuhet se: “Pedagogu i lëndës përgatit tezat e provimit të cilat pasi miratohen nga përgjegjësi i departamentit depozitohen në departament të paktën 2 ditë para provimit”. Proviet sekretohen duke I dhënë procesit paanshmëri në vlerësimin e tezës.</p> <p>Referuar syllabusit, kontrolli i vazhdueshëm i njohurive dhe dijeve të tyre vlerësohet:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Komponentët e vlerësimit</th> <th>Pesha (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Provimi i ndërmjetëm</td> <td>20</td> </tr> <tr> <td>Pjesëmarrja dhe aktivizimi</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>Detyra e kursit</td> <td>20</td> </tr> <tr> <td>Provimi përfundimtar</td> <td>50</td> </tr> <tr> <td><b>TOTALI</b></td> <td><b>100</b></td> </tr> </tbody> </table>	Komponentët e vlerësimit	Pesha (%)	Provimi i ndërmjetëm	20	Pjesëmarrja dhe aktivizimi	10	Detyra e kursit	20	Provimi përfundimtar	50	<b>TOTALI</b>	<b>100</b>
Komponentët e vlerësimit	Pesha (%)												
Provimi i ndërmjetëm	20												
Pjesëmarrja dhe aktivizimi	10												
Detyra e kursit	20												
Provimi përfundimtar	50												
<b>TOTALI</b>	<b>100</b>												
<b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	<p>Në Rregulloren e Universitetit Barleti, neni 85; 86; 87; 88; 89 është përcaktuar procesi dhe kuadri i vlerësimit të njohurive. (Evidenca 2. RREGULLORJA E UNIVERSITETIT BARLETI). Vlerësimi i vazhduar i punës së studentëve zhvillohet përgjatë të dy semestrave të vitit akademik (15 javë kalendarike një semestër). Procesi i testimit është me sekretim. Në Rregulloren e Universitetit, neni 88 thuhet se: “ Provimet e sekretuara hapen pas korigjimit/vlerësimit nga pedagogu në një seancë të parashikuar për dhënie të rezultateve të vlerësimit të studentëve. Kjo seancë parashikohet dhe i bëhet me dije studentëve gjatë ditës së provimit, dhe nuk mund të jetë më shumë se 5 ditë kalendarike”. Studentët marrin komente dhe vlerësime për detyra kurse, projekte, prezantime, teste formuese shoqërohet me komente për studentin me qëllim që ai të kuptojë gjendjen dhe të nxitet për t’u përmirësuar.</p> <p>Për zhvillimin e testit përmbledhës zhvillohet paraprakisht seancë shpjeguese me studentët, bëhet përmbledhje e temave dhe koncepteve kryesore të trajtuara, zhvillohet me ta model testi final dhe rishpjegohen kriteret e vlerësimit. Të gjitha këto synojnë që studenti të përmirësohet në performancën që do të paraqesë dhe të jetë i vetëdijshëm për vlerësimin. (Ev 26 Model teze provimi lende)</p>												
<b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Baza ligjore ku përfshihen rregulloret e të gjitha niveleve institucionale dhe Kodi i etikës së UniBa, nuk e tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. Bazuar në RVB dhe takimet e realizuara në institucion rezultojnë se infrastruktura fizike e auditoreve ku zhvillohet provimi janë në kushte optimale. Provimi monitorohet nga stafi i departamenti (i caktuar si asistues krahas lektorit të lëndës) dhe sekretaria. Nuk lejohet përdorimi i celularëve. Po ashtu nuk lejohet hyrja e individëve që nuk kanë lidhje me provimin. (Evidenca 2. RREGULLORJA E UNIVERSITETIT BARLETI; 00 RVB i BSc ne Shkenca politike)												
<b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Universiteti ka një politikë të sekretimit të fletëve të provimit duke mbështetur një vlerësim luajal dhe në bazë të meritës. Sikundër është përmendur dhe më herët në Rregulloren e Universitetit përcaktohen afatet dhe procedura e njohjes me rezultatet akademike të studentit. Më konkretisht, provimet e sekretuara hapen pas korigjimit/vlerësimit nga pedagogu në një seancë të parashikuar për dhënie të rezultateve të vlerësimit të studentëve. Kjo seancë parashikohet dhe i bëhet me dije studentëve gjatë ditës së provimit, dhe nuk mund të jetë më shumë se 5 ditë												

	<p>kalendarike”. Vlerësimet e studentëve dokumentohen në fletën e vlerësimit dhe në Regjistrin e Rezultateve Akademike. Procesverbali i vlerësimit semestral/vjetor plotësohet nga pedagogu/ pedagogët në përfundim të procesit të vlerësimit dhe dorëzohet në sekretari jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dita e provimit. Fleta e vlerësimit – procesverbali firmoset nga Dekani i Fakultetit dhe kryesekretarja. (Ev 11.8 Proces verbal i vlerësimit)</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Në aktet rregullatore të institucionit garantohej e drejta e studentit që të njihet/ dhe ankimojë rezultatin e vlerësimit të dijeve tek çdo lëndë. Në datën e komunikuar që gjatë ditës së provimit, pedagogu i lëndës takohet me studentët ku ju komunikon rezultatin e provimit dhe pas dakordësisë, i regjistron këto rezultate në fletën e vlerësimit. Ky proces ju mundëson studentëve të njihen paraprakisht me rezultatet e tyre dhe notën përkatëse. Neni 90 “Ankimimi për vlerësimin” i Rregullores së Universitetit përcakton procedurën e rishikim të vlerësimit në rastet kur student nuk bie dakortë për mënyrën e vlerësimit.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Rregullores së Universitetit (nenit 90), studenti ka të drejtën e ankimit për vlerësimin e marrë dhe të marrë përgjegje sipas rregullave të përcaktuara. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 48 orëve nga marrja e komunikimit të notës pas përfundimit të modulit/lëndës, por para shënimit të notës në Regjistrin e Arritjeve Akademike.</p> <p>Përgjegjësi i departamentit bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë në dijeni dekanin, i cili brenda 48 orësh ngre një komision <i>ad hoc</i> për shqyrtimin e ankesës. Me miratimin e dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit ose përsëritjen e tij me komisionin e miratuar nga dekanin</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet në institucion, GVJ konkludon se institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit. Kontrolli i dijeve dhe vlerësimi i studentëve bëhet në mënyrë transparente. GVJ shpreh vlerësimin: Përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi III.4</b>  <b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b></p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Në Rregulloren e Programit të Studimit bachelor në “Shkenca Politike” (neni 3) janë përcaktuar qartë objektivat e këtij programi studimi, të cilat synojnë të pajisin studentët me një formim akademik bazë të përqëndruar në njohuritë dhe kompetencat kyçe të domosdoshme për ti përdorur në karrierë profesionale në fushën e shkencave politike. Gjithashty synohet që përmes lëndëve me zgjedhje student të pajiset me njohuri plotësuese. Gjithashtu program (Ev 2 Dosja e programit) ofron njohuri të përgjithshme dhe specifike, të mbështetura në lëndë të formimit bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, si edhe plotësuese. Nëpërmjet kërkimit të zhvillohet dija dhe të përmirësohet praktika. (Ev 3 Rregullore program)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së</p>	<p>Në programin e studimit bachelor në “Shkenca Politike” në vitin e parë zhvillohen lëndë të cilat mundësojnë dhe garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit si “Teknologji informacioni”, humane si “Sociologji”;</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


E-mail: info@ascal.al

informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	“Antropologji sociale” etj. Kurrikula është e organizuar në mënyrë të tillë që të aftësojnë studentin dhe në drejtime të tjera jashtë fushës së Shkencave Politike, por e ndërlidhur me të, respektivisht në fushën e drejtësisë, ekonomisë etj. (Ev 2 Dosja e programit)			
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studentin, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Forma e testimit të vazhdueshëm që bëhet për çdo lëndë mundëson vlerësimin e kompetencave dhe aftësive që merr studentin hap pas hapi përgjatë vitit akademik. Në përfundim të lëndës pedagogët bëjnë një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara. Ata qartësojnë përmbajtjen mbi të cilën do të ndërtohet teza e provimit përfundimtar dhe në shumë raste zhvillojnë edhe një model teze që u shërben studentëve të njihen me treguesit kryesorë që kanë lidhje me llojin dhe numrin e pyetjeve, nivelet e vështirësisë së pyetjeve dhe pjesët e programit që përfaqësojnë, kohën e testit dhe mënyrën e vlerësimit të përgjigjeve. (Ev 2 Dosja e programit) Gjithashtu, departamenti realizon një analizë vjetore ku synohet niveli i kompetencave profesionale të fituara nga studentët në përfundim të vitit akademik, sfidat në arritjen e tyre, efektiviteti i metodave të zbatuara në mësimdhënie, përfshirja dhe aktivizimi i studentëve në mësimdhënie dhe të nxënë. (Ev 22.1 Analize e dept 20-21).			
<b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuar kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Bazuar në RVB, dokumentacionin e paraqitur nga UniBa dhe vizitën në institucion rezulton se për realizimin e programit bachelor “Shkenca Politike” stafi akademik angazhohet që mësimdhënia të realizohet mbi bazë kompetencash dhe t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në kontekstin teorik dhe zbatimit praktik përmes praktikës mësimore. Kurrikula e këtij programi formon dhe zhvillon kompetenca të përgjithshme, speciale dhe të transferueshme të cilat mundësojnë një formim cilësor të studentit. (Ev 2 Dosja e programit; 00 RVB i BSc ne Shkenca politike)			
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Institucioni ka një praktikë të mirë organizuar lidhur me aktivitetet ekstrakurrikulare që organizohen nga stafi akademik dhe staf të ftuar. Departamenti ka një planë vjetor të aktiviteve ku pasqyrohen personat që do të angazhohen, tematika që do të trajtohet dhe koha e realizimit. (Ev 32 Kalendarin e aktiviteve te dept) Personeli akademik i brendshëm dhe i ftuar ka realizuar leksione të hapura dhe seminare për zhvillime të reja të rëndësishme të shkencës dhe teknologjisë. Në këtë drejtim ai zhvillon <i>open innovation</i> në lidhjet e tij të ngushta me bizneset dhe industrinë.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se institucioni ka ngritur strukturat përkatëse për garantimin e rritjes së aftësive krijuese dhe zbatuese tek studentët, duke i motivuar ato dhe në kërkimin shkencor dhe të aplikuar. GVJ shpreh vlerësimin: Përbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	
			X	

**Standardi III.5****Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Institucioni ka të përcaktuar qartë si në Rregulloren e UniBa dhe atë të programit të studimit realizimin e detyrimeve përmbyllëse. Bazuar në rregulloren e institucionit, si dhe programit të studimit. Studentët njihen heret me këtë detyrim dhe hapat që duhen përmbyllur.</p> <p>Në nenin 16 të Rregullores së Programit të studimit thuhet se:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1- Për të fituar diplomën “Bachelor” në “Shkenca Politike” student duhet të ketë siguruar 180 kredite.</li> <li>2- Studimet përmbyllen me provën finale që do të jetë në trajtën e provimit të përgjithshëm përfundimtar me përjashtim të studentëve me mesatare jo më të ulët se 9.5, të cilët mund të zgjedhin temë diplome.</li> </ol> <p>Në rastet kur studenti nuk ka një mesatare mbi 95, e përfundon programin e studimit me provim përfundimtar. Departamenti ka hartuar Udhëzues për provimin e formimit (Ev 2.1 Programi i prov. Formimit). Kur studenti përgatit temë për mbrojtjen e provës finale, ky proces realizohet para komisionit të posaçëm që ngrihet nga departamenti për këtë qëllim.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit bachelor në “Shkenca Politike”, dhe më specifikisht përgjegjësi i departamentit, asiston dhe ndihmon studentët duke iu dhënë atyre informacion, të dhëna, udhëzime për materialet në funksion të realizimit të detyrimeve përmbyllëse.</p> <p>Për këtë, Departamenti, ka vënë në dispozicion të studentëve një udhëzues Programi i provimit të formimit (Ev 2.1 Programi i prov. Formimit).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e programit të studimit Kreu IV (neni 22 dhe neni 23). Në nenin 22 është përcaktuar “Procedura e diplomimit” ku për të fituar diplomën bachelor në “Shkenca Politike”, studentit duhet të ketë marrë 180 kredite. Gjithashtu përveç arritjes së rezultateve pozitive përgjatë të gjitha kurseve dhe kryerjes së praktikës, studentët duhet t’i nënshtrohen edhe provës finale e cila është në trajtën e provimit të formimit. Mbrojtja e provës finale bëhet në dy sesione: i verës dhe i dimrit të cilat përcaktohen në kalendarin akademik.</p> <p>Departamenti propozon komisionet të cilat duhet të jenë me jo më pak se tre anëtarë nga departamenti. Komisioni miratohet nga Dekani i Fakultetit. (RVB; Ev 13 Rregullore diplomimi)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Personeli akademik udhëzohet dhe orienton studentët rreth temave dhe njohurive që do të testohen në provimin final (Evidenca 5. Paketa e provës finale). Në bazë të nenit 25 “Koordinatori i Departamentit” të Rregullores së Universitetit, Koordinatori I programit në është “personi përgjegjës për organizimin e punës për përgatitjen e platformës së pyetjeve të provimeve të formimit dhe koordinimit të procesit në përputhje me udhëzimet e tij...”.</p> <p>Për studimet që përbyllen me temë diplome është përgjegjësi e Udhëheqësit të diplomës t’i ofrojë studentit mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme për të arritur standarde të larta të punimit. Kjo përfshin ndihmën për formulimin e titullit të punimit, për përgatitjen e propozimit dhe të platformës së punimit, rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të tjera të informacionit, konsulencën për organizimin e shënimeve dhe përgatitjen e punimit.</p> <p>Udhëheqësi ka përgjegjësinë të vetëdijësojë studentin për rrezikun e falsifikimeve dhe të plagjiaturës, të bëjë kritikën e duhur për punimin e studentit dhe komentet konstruktive brenda kohës së caktuar dhe në kohën e mbrojtjes së punimit të konfirmojë se punimi i plotëson kërkesat dhe standardet e kërkuara për fitimin e</p>

	diplomës.																
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në varësi të temës dhe fushës së studimit institucioni krijon kushte të përshtatshme për mbështetjen e studentit si brenda institucionit, në njësitë e grupit “Barleti”, si edhe jashtë tij në institucionet partnere. (Evidenca 15. Lista e marreveshjeve të bashkepunimit)																
<b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. Sistemi i pikëzimit është si vijon: <table border="1" data-bbox="769 405 1297 647"> <thead> <tr> <th>Shkalla e pikëve</th> <th>Përshkrimi i notës</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>96 – 100</td> <td>Shkëlqyeshëm</td> </tr> <tr> <td>86 – 95</td> <td>Shumë mirë</td> </tr> <tr> <td>76 – 85</td> <td>Mirë</td> </tr> <tr> <td>66 – 75</td> <td>Kënaqshëm</td> </tr> <tr> <td>56 – 65</td> <td>Mjaftueshëm</td> </tr> <tr> <td>50 – 55</td> <td>Kalueshëm</td> </tr> <tr> <td>Me pak se 49</td> <td>Mbetës</td> </tr> </tbody> </table> <p>(Evidenca 5. Paketa e proves finale)</p> <p>Në rastin e punimit të diplomës vlerësimi bëhet sipas një grup komponentësh. Më konkretisht: hyrja – 10%; Shqyrtimi I literaturës së fushës dhe të çështjes – 20%; Metodologjia – 15%; Rezultatet e studimit – 20%; Diskutimi – 20%; Përfundime 10% dhe Literatura 5%.</p> <p>Diploma, shoqëruar me suplementin është hapi i fundit. Studenti pajiset me diplomën, suplementin e diplomës, si dhe listën e notave të lëshuara nga UniBa dhe të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit në Republikën e Shqipërisë.</p>	Shkalla e pikëve	Përshkrimi i notës	96 – 100	Shkëlqyeshëm	86 – 95	Shumë mirë	76 – 85	Mirë	66 – 75	Kënaqshëm	56 – 65	Mjaftueshëm	50 – 55	Kalueshëm	Me pak se 49	Mbetës
Shkalla e pikëve	Përshkrimi i notës																
96 – 100	Shkëlqyeshëm																
86 – 95	Shumë mirë																
76 – 85	Mirë																
66 – 75	Kënaqshëm																
56 – 65	Mjaftueshëm																
50 – 55	Kalueshëm																
Me pak se 49	Mbetës																
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studenti, që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur provën finale (provim formimi ose punim diplome) pajiset nga UniBa me Diplomën përkatëse, e cila shoqërohet me suplementin e diplomës. Diploma nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit pjesë e të cilit është dhe departamenti që ofron programin e studimit dhe Rektori i UniBa-s. Për secilin prej tyre shënohet emri, mbiemri, grada dhe titulli shkencor. Nënshkrimet vërtetohen me Vulën e UniBa-s.																
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Modeli i diplomës është ai që është hartuar në përputhje me aktet rregulluese, i miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe i regjistruar në QSHA. (Ev 2 Diploma dhe supleme)																
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Në përfundim të studimeve, sipas kërkesë së studentit, studentit i vihet në dispozicion edhe një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit. (Evidenca 2. RREGULLORJA E UNIVERSITETIT BARLETI; neni 101)																
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Gjatë vizitës në institucion dhe takimin e realizuar me sekretarinë mësimore u konstatua se në arkivën e Sekretarisë Mësimore mbahen deri në përfundim të studimeve të studentit dhe pajisjes me diplomën përkatës, dokumentacioni në vijim: <ol style="list-style-type: none"> <li>1- Dosja personale e studentit,</li> <li>2- Rregjistrat mësimorë,</li> <li>3- Fletet e vlerësimit të firmosura nga Dekani i Fakultetit dhe përfaqësuesi i autorizuar i sekretarisë mësimore,</li> <li>4- Regjistri i lëshimit të diplomave,</li> <li>5- Rregjistrat e studentëve me të gjitha të dhënat dhe rezultatet sipas përcaktimeve të Minsitrisë përgjegjëse për arsim, kalendari akademik, planet mësimore (origjinale të dyta),</li> <li>6- kopje e diplomës së lëshuar, dorëzuar nga studenti.</li> </ol> <p>Ky dokumentacion aksesohet sa herë lind nevoja ose kërkohet informacion në lidhje me studentët. Tezat e provimit të studentit ruhen për një periudhë 3 mujore sipas rregullores së protokoll arkivës dhe të sekretarisë mësimore.</p> <p>(Ev 19.1 Rregullore e Sekretarisë Mësimore; Ev 24 Rregullore Protokoll - Arkive)</p>																
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konkludon se institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblylëse të studentit në programin e studimit si dhe e pajis studentin me</i>																





	<i>dokumentacionin përkatës pas përfundimit të studimeve. GVJ shpreh vlerësimin: Përbushet plotësisht.</i>		
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X

<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

##### Standardi IV.1

**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	<p>Bazuar në shqyrtimin e dosjeve të personelit akademik, vizita në institucion dhe bisedat me stafin akademik dhe me personelin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, GVJ konfirmon se UniBa ka personel akademik që përbush standardet e cilësisë. Niveli i kualifikimit akademik i kërkuar për personelin efektiv dhe me kontratë që mbulon programin Bachelor në Shkenca Politike mjafton të jetë me Master Shkencor (Ligji 80/2015), ndërkohë që i gjithë personeli akademik i përbush dhe tejkalon kriteret ligjore për mbulimin e moduleve. Gjatë periudhës 2019-2022, Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit që angazhohet në realizimin e programit të studimit ka 7 PAE (1 Prof.Asoc.Dr. + 2 Dr. + 4 Msc.), sikurse angazhohet personel akademik nga departamentet e tjera të UniBa (Ev 30. Tabelat Përmbledhëse, Tabela 1 dhe 2). Në vitin 2021-2022 programi është mbyllur dhe në vitin 2022-2023 ka vetëm studentët e vitit të tretë.</p> <p>UniBa në dokumentet e brendshme ka përcaktuar që stafi akademik të ketë diplomë e ciklit të parë dhe të dytë sipas fushës akademike, ndërsa nga verifikimi i dosjeve ka raste nga personeli akademik efektiv që nuk i kanë të dyja ciklet në shkenca politike (Evidenca 7. Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore). Megjithatë UniBa përcakton se stafet akademike marrin me përparësi module të profilit të tyre akademik dhe i japin ato në disa degë studimi, kjo ju mundëson të profilizohen në një drejtim dhe të sigurojnë nivel të lartë kualifikimi (Ev 11.5.2 Udhëzimi i Rektorit mbi ngarkesën mësimore).</p> <p>Dosja e personelit mësimdhënës përmban të dhëna të detajuara për Syllabusin e lëndës të hartuar konform rregullave të përcaktuara (Ev. 11.6 Dosja e Pedagogut). Nga komunikimet e GVJ me pedagogët dhe studentët, si dhe përshtypjet e studentëve rezultojnë një vlerësim shumë i mirë për stafin akademik.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	<p>Nga bisedat e GVJ me personelin akademik efektiv të angazhuar në këtë program studimi Ba. Shkenca Politike në UniBa, takimet në Zyrën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe shqyrtimit të Udhëzimit të Rektorit mbi ngarkesën mësimore, (Ev 11.5.2 Udhëzimi i Rektorit mbi ngarkesën mësimore), (Ev 11.5.2 Udhëzimi i Rektorit nr.7, datë 30.06.2022 Lidhur me punën për hartimin e ngarkesës mësimore – pavarësisht se shumica e dokumenteve janë të vitit të fundit akademik, rezultojnë se kjo praktikë ka qenë në vazhdimësi, edhe për periudhën e mëparshme që është objekt i këtij vlerësimi), si dhe Tabelës së shpërndarjes së ngarkesës për periudhën në</p>

	<p>shqyrtim (Ev.30 Tabelat Përmbledhëse), GVJ konstatoi se ngarkesa mësimore ishte me shtrirje horizontale në disa programe, brenda dhe jashtë departamentit, që shkonte mesatarisht në rreth 300 orë në auditor (kategoria Prof.Asoc.Dr., viti 2021-2022), me 6 module. Në Manualin e MBNJ përcaktohet si normë 360 orë minimale në auditor që është disi e lartë, referuar kornizës ligjore në fuqi, ku për kategorinë “profesor” norma është 140 orë/vit. Stafit akademik respektonte 3 module në semester, duke mos zhvilluar më tepër se dy module me të njëjtin grup studentësh, sipas rregullit të vendosur në UniBa. Ngarkesa e personelit akademik efektiv përfshinte, jo vetëm ngarkesën mësimore, e cila përbën rreth 50% të ngarkesës së punës, punën shkencore me rreth 20% , punën administrative, punën me studentët dhe aktivitete që organizonte UniBa me rreth 30% të volumit të punës së personelit akademik efektiv (GVJ verifikoi vlerësimet e vena në dispozicion për dy PAE gjatë vizitës në UniBa).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Për periudhën e akreditimit, dëshmohet qëndrueshmëri e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, ndonëse në vizitën që GVJ realizoi u konstatuan lëvizje të stafit akademik, përfshirë edhe përgjegjësin e departamentit, përgjatë vitit akademik 2022-2023 që nuk prek periudhën e akreditimit. Çfarë na bëri përshtypje ishte përcaktimi në Manualin e BNJ që leje për kualifikime (konferenca, trajnime...) jepej vetëm për 7 ditë të pagueshme, dhe 30 ditë pa të drejtë page (Evidenca 7. Manuali i BNJ). Kodi i Punës parashikon për arsye familjare dhe shëndetësore 30 ditë pa të drejtë page, kurse këtu aplikohet për punë kërkimore! Këto limite mund të shkaktojnë pakënaqësi të stafit akademik që ka angazhime në kërkime shkencore i cili mund të lëvizë në rast të një oferte më të mirë. Dosjet e personelit të vena në dispozicion gjatë takimit me ZMBNJ përfshijnë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore për të gjithë personelin akademik (Evidenca 7.1.Dosja personale e stafit).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Nga bisedat me stafin akademik dhe nga shqyrtimi i dosjeve, doli qartë se Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ndjek procedura të rregullta rekrutimi dhe vlerësimi (Evidenca 7. Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore) dhe Udhëzimet e Rektorit për Rekrutimet (Ev.11.5.1). Kjo zyrë ka përgjegjësi për zbatimin e kritereve në rekrutimin dhe vlerësimin e stafit akademik, që nga kriteret e përgjithshme: a) Diplomë e ciklit të parë dhe të dytë sipas fushës akademike, deri tek kriteret specifike sipas rastit të cilat bëhen publike në faqen zyrtare të UniBa. Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e publikon shpalljen për vendet vakante, duke specifikuar nivelin e kualifikimit, detyrat e vendit të punës, dokumentacionin e kërkuar, që garantojnë përzgjedhjen e personelit të kualifikuar (<a href="http://umb.edu.al/zyra-e-menaxhimit-te-burimeve-njerezore.html">http://umb.edu.al/zyra-e-menaxhimit-te-burimeve-njerezore.html</a>). Një pjesë e mirë e stafit akademik kishte vite përvojë pune në UniBa në këtë program studimi, si titullarë të të njëjtave module (Z.Ç., E.K.), që tregojnë se ata kanë avancuar në këtë drejtim. Sa i takon procedurave të vlerësimit, ato kanë disa nivele që nga drejtuesi i Departamentit, ZMBNJ, personeli akademik, studentët dhe vetëvlerësimi që secili bën për përmbushjen e detyrimeve sipas disa shtyllave kryesore: shtylla akademike, e cila përfshinte të gjitha veprimtaritë e procesit të mësimdhënies; shtylla e kërkimit shkencor; shtylla e studentëve dhe marrëdhënieve me komunitetin; shtylla administrative dhe shtylla e sipërmarrjes: <a href="https://www.umb.edu.al/mps.html">https://www.umb.edu.al/mps.html</a>. GVJ gjatë takimit me ZMBNJ shqyrtoi vlerësimet e dosjeve të D.J dhe ZH.K. dhe konfirmon aplikimin e procedurave të vlerësimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Shkenca Politike nuk parashikon orë laboratorike dhe nuk ka nevojë për laboratorë specifike, ndonëse UniBa ka laboratorë me kompjutera që përdoren për lëndët “Teknologji Informacioni” dhe “Metodat e Kërkimit”, me të cilat studentët njihen që në vitin e parë. Institucioni ve në dispozicion stafin ndihmës për asistencën e stafit akademik dhe studentëve dhe mirëmbajtjen e City Lab.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

studimit.	
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Nga vizita në institucion, bisedat me personelin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (ZMBNj), shqyrtimin e dosjeve të personelit akademik, GVJ konfirmon se UniBa ka rregulla të përcaktuara për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe një njësi përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit akademik, të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, atij ndihmësimor-shkencor dhe administrativ. Për secilin person të angazhuar në UniBa, Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore mbledh dhe administron dokumentacionin sipas formateve të unifikuara të Dosjes personale të stafit, i ka ato të ruajtura ndër vite, dhe specifikisht në semestra (Evidenca 7.1.Dosja personale e stafit). (Evidenca 30. Tabelat përmbledhëse, Tabelat 1-6). Këto të dhëna administrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Nga biseda me drejtuesit e institucionit dhe studentët, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit (Evidenca 2. Dosja e Programit të Studimit), UniBa përfshin grupet e interesit, ku janë përfaqësues të administratës publike në nivel qendror apo vendor, biznese e organizata të shoqërisë civile, në të gjitha hapat e realizimit të programit të studimit, përfshirë edhe praktikat profesionale të studentëve (Evidenca 15. Marrëveshjet e Bashkëpunimit). Këto marrëveshje bashkëpunimi shtrihen që nga IAL homologe, përfshirë universitete publike e private nga ku rekrutohet PAK, p.sh. Universiteti i Elbasanit, deri tek institucionet publike, Bashkitë, dhe sipërmarrje private, brenda dhe jashtë vendit, p.sh. Universiteti Nënë Tereza, Shkup. Koordinator i departamentit mbikëqyr studentët në praktikat profesionale (E.3.1 Vendim për emërimin e koordinatorit të departamentit). Duhet theksuar se Shtylla e Studentëve dhe Marrëdhëniet me Komunitetin përbën një nga komponentët kryesorë edhe të vlerësimit të performancës së personelit akademik në UniBa: <a href="https://www.umb.edu.al/mps.html">https://www.umb.edu.al/mps.html</a>. Si nivel Bachelori diploma mbrohet me provim dhe nuk ka pasur raste me punim diplome.</p>
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Nga biseda me koordinatorin e Departamentit, drejtuesit e zyrës së karrierës dhe me studentët rezultojnë se personeli mbikëqyrës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale (Ev.2.2 Paketa e praktikës) në bazë të marrëveshjeve (Evidenca 15. Marrëveshjet e Bashkëpunimit) është shumë mbështetës. Në disa raste janë studentët e diplomuar në UniBa dhe që e kanë të qartë sesi t'i ndihmojnë studentët në përmbushjen e detyrimeve të praktikës. Koordinator i departamentit bashkëpunon me ish studentë të diplomuar në UniBa që janë të punësuar në këto institucione ku ka marrëveshje dhe që përcjellin jo vetëm profesionalizëm, por edhe modele frymëzimi për studentët. Krahas marrëveshjeve formale, UniBa ka përdorur edhe netëorkun e stafit akademik për kyerjen e praktikave që janë zhvilluar në bashki, duke shfrytëzuar lidhjet e Përgjegjës të Departamentit në atë periudhë e viteve të akreditimit, i cili vinte nga pozicioni kryetar i njësisë së qeverisjes lokale në Tiranë; po ashtu, praktikat janë kryer edhe në organizata të shoqërisë civile.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Personeli akademik që mbulon programin e studimit Bachelor në Shkenca Politike përmbush standardet e cilësisë si për nga niveli i kualifikimit, përvoja në punë, qëndrueshmëria në këtë departament, në përputhje me fushën e programit, kërkesat ligjore dhe për garantimin e standardeve të mësimdhënies. Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ka të përcaktuara qartë në Manualin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore rregullat dhe procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të personelit akademik dhe mbështetës të angazhuar në këtë programi studimi. Ngarkesa mësimore e stafit shkon deri në 6 module, 3 në semestër, konform legjislacionit në fuqi. Koordinator i Departamentit bashkëpunon me institucionet për mbikëqyrjen e praktikave</i></p>



	<i>profesionale të studentëve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X	

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Vizita e GVJ u krye në mjediset e reja të UniBa, Kampusi 2 i cili ndodhet në Rrugën Frang Bardhi dhe shtrihet në një sipërfaqe të shfrytëzueshme prej 6,451 m <sup>2</sup> (Evidenca 00. RVB, Evidenca 30. Tabelat përmbledhëse, Tabela 16). Për numrin e ulët të studentëve të këtij programi studimi, GVJ gjykon se UniBa garanton mundësi të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Ndërtimi i godinës së re në kampusin 2, sikurse dhe rikonstruktimi i godinës ekzistuese në këtë kampus, garantojnë kushte infrastrukturorë bashkëkohore, në aspektin teknik dhe didaktik, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit Bachelor në Shkenca Politike dhe moduleve përkatëse. Mjediset janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për klasa leksioni/seminari, zyra për stafin, biblioteka në funksion të zhvillimit sipas parametrave bashkëkohore të programit të studimit. Krahas tyre UniBa ofron edhe mjediset sportive dhe mbështetëse deri tek bare e restorante. Të gjitha këto mjediset u shkelën nga GVJ gjatë vizitës në institucion (shifrat nga RBV dhe Evidenca 30).
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjediset tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset mësimore infrastrukturorë në Kampusin 2 ku zhvillohet programi i studimit Bachelor në Shkenca Politike janë të pajisura me teknologjinë e fundit dhe garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, në përputhje me programin e studimit. Të gjitha mjediset mësimore janë të pajisura me smartboard dhe sisteme projektimi digjital dhe stafet akademike dhe studentët konfirmuan përdorimin e metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies në auditoret e UniBa. I gjithë kampusi është i mbështetur edhe me rrjetet eifi dhe pajisjet e nevojshme elektronike si PC, laptop, printera, etj në zyrat e stafit akademik dhe atij administrativ (U provuan nga GVJ gjatë vizitës në institucion).
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Programi i studimit Bachelor në Shkenca Politike nuk parashikon orë laboratorike dhe nuk ka nevojë për laboratorë specifikë. Sikurse u parashtrua më lart, kushtet e mjedisit në UniBa janë mëse të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit. UniBa ka laboratorë me kompjutera që përdoren për lëndët “Teknologji Informacioni” dhe “Metodat e Kërkimit” të vitit të parë në këtë program studimi.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Nga vizita në mjediset e UniBa, GVJ konfirmon pajisjen e mjedisëve me teknologjine e nevojshme për sigurimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies maksimale. UniBa ka dy laboratorë të teknologjisë së informacionit në katin e parë, të aksesueshëm si nga stafi akademik edhe studentët, të cilët ata i përdorin gjatë lëndëve të ndryshme. Konkretisht për këtë program studimi ato përdoren veçanërisht për lëndën Teknogji Informacioni dhe punimit të detyrave të kursit (Konfirmuar nga biseda me stafet dhe studentët).
<b>Konkluzione</b>	<i>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmon se UniBa vë në dispozicion</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<i>mjedise mësimore dhe kushte infrastrukturore bashkëkohore, në aspektin teknik dhe didaktik, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit Bachelor në Shkenca Politike dhe moduleve përkatëse. Stafet akademike dhe studentët konfirmuan përdorimin e metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies në auditorët e UniBa.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi IV.3

**IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ vizitoi Bibliotekën, shqyrtoi literaturat e detyrueshme në syllabuset e lëndëve karakterizuese të programit dhe pas diskutimeve me stafin akademik dhe studentët konkludon se studentët kanë literaturën bazë dhe ndihmëse në dispozicion për marrjen e njohurive të parashikuara në programin e studimit. Biblioteka e UniBa është e pajisur me literaturë fizike, në gjuhën shqipe dhe të huaj, në përputhje me natyrën e programit të studimit, por ka vend për shtimin e saj me literatura të 5 viteve të fundit (Ev 25. Të dhëna për Bibliotekën).
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Nga biseda me stafin akademik dhe bibliotekaren e institucionit u konfirmua që në çdo viti akademik, Departamenti propozon një listë të përditësuar me libra për bibliotekën, që janë të përfshirë në literaturën e programit mësimor Bachelor në Shkenca Politike (Evidenca 25.1. Pasurimi i Bibliotekës). Pavarësisht pasurimit periodik të fondit të bibliotekës, ajo ka nevojë të shtojë librat fizikë të botimeve të fundit në shkencat politike, si nga autorë vendas apo edhe përkthime, të cilat janë të pakta edhe në literaturën e përcaktuar në syllabuset e lëndëve. Ato sigurisht që kompensohen me aksesin në bibliotekat online, veçanërisht pas situatës së pandemisë së Covid-19 që korrespondon me periudhën e marrë në shqyrtim. Aktualisht vëmendja e pedagogëve dhe studentëve është përqëndruar tek bibliotekat online.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	GVJ vizitoi Bibliotekën në katin e 1-rë të Kampusit 2 me një hapësirë 27.3 m2 e cila zgjerohet me një hapësirë tjetër prej 95.1 m2 ku janë të arkivuara revistat e punime shkencore. Në katin përdhe ka edhe një hapësirë 70 m2 dhe me 28 vende me kompjutera për aksesimin në bibliotekat dixhitale (GVJ verifikoi të dhënat e RVB dhe Evidenca 25. Të dhëna për Bibliotekën). Këto të dhëna tregojnë se për numrin e studentëve të këtij programi studimi, Biblioteka garanton mundësi për të gjithë me kompjutera për aksesimin në bibliotekën dixhitale të universitetit.
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka e UniBa është e pajisur me literaturë fizike si tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, libra apo revista shkencore në gjuhën shqipe dhe të huaj, në përputhje me natyrën e programit të studimit (Evidenca 25. Të dhëna për Bibliotekën). GBJ konstatoi se Biblioteka ka nevojë të pasurohet me botimet e viteve të fundit si nga studiuesit shqiptarë edhe të huaj në fushën e shkencave politike, të cilat duhet të vendosen edhe në syllabuset e lëndëve, por që pak lëndë ka që reflektojnë literatura të 5 viteve të fundit. Nevoja për botime bashkëkohore u evidentua edhe gjatë bisedës me stafin akademik në institucion.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë	UniBa u krijon kushte studentëve, sikurse edhe stafit akademik, për të aksesuar pa

kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	pagesë bibliotekat online si bibliotekat dixhitale EconBiz, JSTOR, Ebsco Open Dissertation, si dhe Springer, ku mbulohen të gjitha fushat e shkencës e teknologjisë, përfshirë edhe shkencat politike e shoqërore (Biseda me bibliotekaren në Kampusin 2 për të konfirmuar RVB, Evidenca 25. Të dhëna për Bibliotekën).			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	GVJ e testoi biblioteken e Kampusit 2 të pajisur me programe kompjuterike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët e programit Bachelor në Shkenca Politike, të cilët nuk kanë nevojë për programe të sofistikuara dhe janë në numër të kufizuar për kapacitetet e kosiderueshme të Bibliotekës.			
<b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka është në dispozicion të studentëve në orare shërbimi për të gjithë kohëzgjatjen e orarit zyrtar të punës së institucionit dhe me oraret e zhvillimit të procesit mësimor 08:00-16:30, por jo përtej tyre. Por studentët mund të studiojnë në bibliotekë edhe pas këtij orari deri në 19:45, ndonëse asnjë nga studentët e intervistuar nuk e kërkonte një gjë të tillë. GVJ sugjeron që Biblioteka mund të ketë fleksibilitet në oraret që mund të jenë përtej orareve të shërbimeve të tjera administrative të UniBa, jo domosdoshmërisht për studentët e këtij programi studimi.			
<b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Gjatë takimit të GVJ në institucion, Bibliotekarja e UniBa na vuri në dispozicion listën e fondit fizik të teksteve bazë për programin Bachelor në Shkenca Politike të cilat i referohen autorëve klasikë, përgjithësisht të përkthyer në shqip, dhe gati 5-6 tekste të autorëve bashkëkohore të viteve të fundit, përfshirë edhe autoren Z.Ç. personel akademik efektiv në këtë program studimi. Po ashtu titujt e artikujve në bibliotekat online si bibliotekën dixhitale EconBiz <a href="https://ëëë.econbiz.de">https://ëëë.econbiz.de</a> (rreth 200 mijë artikuj studime evropiane); JSTOR (books and journals) <a href="https://ëëë.jstor.org">https://ëëë.jstor.org</a> (rreth 180 mijë artikuj politika e BE); Ebsco Open Dissertation <a href="https://biblioboard.com/opendissertation">https://biblioboard.com/opendissertation</a> (rreth 4.5 mijë disertacione studime evropiane); si dhe Springer <a href="https://link.springer.com">https://link.springer.com</a> (rreth 19 mijë artikuj dhe libra për politikën evropiane); (Dokumenti i Bibliotekës me titull: Lista e teksteve/periodikëve në Bibliotekë që na u vu në dispozicion gjatë takimit në institucion; Evidenca 25. Të dhëna për Bibliotekën). Menaxhimi i librave të bibliotekës bëhet nëpërmjet sistemit të platformës online, i cili mundëson menaxhimin e librave të kategorive të ndryshme, kontrollimin me lehtësi për lëshimin/kthimin, vonesat apo dëmtimin e librave. Nisur edhe nga situata e Covid-19 për periudhën e akreditimit, fondi fizik i librave mbetet i papërditësuar, ndërsa prioritet u është dhënë bibliotekave online që duken më të shfrytëzuara, si nga stafet akademike, ashtu dhe nga studentët. Fondi online është veçanërisht i dobishëm për studimin e politikës evropiane dhe politikës së jashtme në përgjithësi, referuar artikujve dhe librave të referuar për secilin link.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi i studimit përmban literaturën e nevojshme në mbështetje të mësimdhënies që ju mundëson stafeve akademike t'i referojnë në syllabuset dhe studentëve t'i përdorin ato. GVJ vizitoi Bibliotekën, shqyrtoi literaturat e detyrueshme në syllabuset e lëndëve të programit dhe pas diskutimeve me stafin akademik dhe studentët konkludon se studentët kanë literaturën bazë dhe ndihmëse në dispozicion për marrjen e njohurive të parashikuara në programin e studimit. Biblioteka e UniBa është e pajisur me literaturë fizike në gjuhën shqipe dhe të huaj në përputhje me natyrën e programit të studimit, të cilat plotësohen nga aksesit në platformat digjitale që janë të aksesueshme pa pagesë si për stafet akademike dhe studentët. Mjediset mbështetëse të bibliotekës, kompjuterat, aksesit në internet kapërcejnë kufizimet e fondit fizik të burimeve të informacionit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Niveli i përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



**Standardi IV.4**

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konfirmon se sistemi për komunikimin e brendshëm përfshin komunikimin online për menaxhimin e të dhënave të studentëve, pas takimeve me stafin akademik, sekretaritë dhe studentët. Gjatë takimeve në institucion, GVJ konfirmon vlefshmërinë e platformës e portalit studentor LMS e Classroom që ju mundëson studentëve të informohen në kohë reale lidhur me aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim (Evidenca 23. Udhëzues për përdorimin e TIK). GVJ gjatë takimit me sekretarinë mësimore konstatoi se UniBa zbaton administrimin e informacionit në mënyrë korrekte.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit në UniBa përfshin platformat e vëna në dispozicion me intranet të monitoruar nga universiteti. Nga komunikimi me personelin administrativ të burimeve njerëzore apo sekretaritë, GVJ konfirmon funksionimin e këtij sistemi të brendshëm të menaxhimit të informacionit, dokumentacionit dhe aktivitetit të personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Ky sistem i menaxhimit online kaloi testin në periudhën e pandemisë Covid-19.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit sigurohet akses i dedikuar nëpërmjet logimit me kredencialet personale, si në intranet, ashtu edhe në platformat online. Personeli që sapo emërohet dhe studentët që sapo rregjistrohen pajisen me adresat e personalizuara të aksesit në informacionet e universitetit, sikurse u konfirmua nga biseda e GVJ me stafin dhe studentët gjatë vizitës në institucion.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Në vitet e pandemisë së Covid-19 me të cilat korrespondon edhe periudha e akreditimit të programit të studimit, aktiviteti mësimor është zhvilluar online në platformat google classroom, ku studentët gjejnë informacionin për lëndët, modulet dhe literaturat. Si për stafin, ashtu edhe për studentët, përmes këtyre platformave janë mundësuar forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit (konfirmuar nga takimet e GVJ me stafin dhe studentët në UniBa).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Përdorimi i sistemeve të menaxhimit të informacionit si më sipër, garanton monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ, duke mundësuar raportimin dhe të dhënat për organet dhe autoritetet drejtuese. Ky përbën edhe një avantazh të UniBa të përmendur nga studentët dhe sekretaria gjatë takimeve të GVJ në institucion).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ kontrolloi informacionin e disponueshëm te faja online të UniBa <a href="http://ëëë.umb.edu.al">ëëë.umb.edu.al</a> dhe konfirmon se ajo është e pasur me informacionin e kërkuar nga studentët, personelin akademik dhe gjithë personat e interesuar mbi programin e studimit dhe aktivitetet e ndryshme. Kjo faqe online është edhe në gjuhën angleze: <a href="https://umb.edu.al/en/fakultetet-dhe-qendrat.html">https://umb.edu.al/en/fakultetet-dhe-qendrat.html</a></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UniBa disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. Si për stafin, ashtu edhe për studentët, përmes këtyre platformave janë mundësuar forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të</i></p>

	<i>informacionit, duke siguruar informacionin në kohë reale. Faqja online e UniBa është edhe në gjuhën angleze, e pasur me informacionin e kërkuar nga studentët, personeli akademik dhe publikun e interesuar.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përm.bushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Raportet me të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, jo vetëm të këtij programi bachelor në shkenca politike, hartohen çdo vit përmes një strukture të veçantë si Zyra për Financën. Aty planifikohen edhe veprimtaritë mbi kërkimin shkencor (konferenca, publikime), ku shpenzimet zenë vetëm 1.5% të totalit, dhe gati 1.2% për projekte. Të ardhurat kryesore rreth 90% vijnë nga pagesat e studentëve të UniBa, ndonëse numri i studentëve në këtë program studimi është i vogël. Tarifat e studentëve janë të krahasueshme me universitetet e tjera private (Ev 28. Burimet financiare të UniBa).
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Plani i financimit i njësisë bazë, Departamentit të Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit, përfshihet në planin e përgjithshëm të institucionit, i cili përmban të dhëna mbi burimet njerëzore, që zenë peshën më të madhe specifike të shpenzimeve, krahas shpenzimeve operative, për bibliotekën dhe detyrimet financiare e grantet (Ev 28. Burimet financiare të UniBa). Nga Raporti Financiar Vjetor dalin qartë të dhënat mbi Strategjinë, misionin dhe objektivat e institucionit, referuar aspekteve ekonomike në funksion të realizimit të të gjitha programeve të studimit, ku përfshihet edhe ai i programit Bachelor në Shkenca Politike (Ev 28.4 Të dhëna nga Raporti Financiar Vjetor).
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Institucioni ka krijuar njësinë e auditimit të brendshëm në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi. Raporti i përvitshëm i Auditimit të Brendshëm ku dokumentohet situata financiare shërben që të vlerësohet efektiviteti financiar i UniBa, bazuar në balancën midis të ardhurave dhe shpenzimeve i cili i dërgohet Bordit të Administrimit të UniBa (Evidenca 28.2 Raport Auditimi i Brendshëm). Auditimi i Jashtëm për periudhën e akreditimit kryhet nga kompania audituese ndërkombëtare "Grant Thornton" (Evidenca 28.3 Raport Auditimi i Jashtëm).
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Zyra e Financës së UniBa harton bilanci financiar vjetorë në përputhje me aktet ligjore dhe të gjitha njësitë bazë, si dhe Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit, informohen për indikatorët kryesorë. Treguesit financiarë si dhe zbatimi i buxhetit bëhen pjesë e analizës në Bordin e Administrimit (Evidenca 28.4 Të dhëna nga Raporti Financiar Vjetor).
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë	Raporti financiar evidenton se burimi kryesor i financimit janë të ardhurat nga tarifat e studentëve dhe fakti që UniBaami ka pasur një numër stabil studentësh ka ndikuar pozitivisht në këtë drejtim, pavarësisht se studentët e këtij programi studimi Bachelor në Shkenca Politike kanë qenë të pakët në numër. Stafi akademik i këtij programi angazhohet edhe në programe të tjera studimi për të arritur të reduktojë

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	kostot e programit dhe ky ka qenë një nga mekanizmat për të balancuar kostot e personelit të këtij programi studimi. Përfshirja në projekte shihet si një mënyrë për të rritur burimet financiare që garantojnë gjenerimin e të ardhurave dhe qendrueshmërinë financiare të UniBa. Nga pasqyrat financiare ndër vite, raportet e auditimit, opinionet dhe sugjerimet e Bordit të Administrimit, rezulton se UniBa nuk ka përdorur rritjen e tarifave të studentëve si një ndërhyrje të posaçme për të rritur të ardhurat financiare. (Evidenca 30. Tabelat Përmbledhëse. Tabela 18).			
<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit përmes tarifave studentore, projekteve dhe të tjera. Zyra e Financës përgatit periodikisht raportet financiare vjetore, auditi i brendshëm shoqërohet edhe nga auditi i jashtëm që konfirmojnë qendrueshmërinë financiare të UniBa. Mbi 90% e financimit të UniBa vjen nga tarifat e studentëve të të gjitha programeve të studimit. Si mjet për të reduktuar kostot e personelit që përbëjnë edhe shpenzimet më të mëdha është zbatuar shtrirja horizontale e ngarkesës së tyre duke dhënë mësim në disa departamente e programe studimi dhe pjesëmarrja në projekte.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X	

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	UniBa, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka përcaktuar politika e procedura si në nivel institucioni ashtu edhe rregullore të programit të studimit, që mbulojnë si kriteret për pranimin e studentëve, ashtu dhe ato për kalimin nga njëri vit tek tjetri, përgjatë një cikli të plotë akademik të studimeve Bachelor (Ev.1.1 Statuti UniBa; Ev 1.2 Rregullore e UniBa; Ev 3. Rregullore e Programit; Ev.20.1 Rregullore e zyrave në shërbim të studentëve, etj.). Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, nga bisedat me studentët dhe sekretaritë mësimore, GVJ konstatoi se institucioni respekton rregullat që janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët	Procedurat e aplikimit në UniBa janë të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit në faqen online: <a href="http://umb.edu.al/procedurat-e-aplikimit.html">http://umb.edu.al/procedurat-e-aplikimit.html</a> Nga biseda me studentët, GVJ vlerëson se të gjithë studentët ishin të kënaqur me mjedisin mbështetës në UniBa nga hyrja në dalje. Zyra e Rekrutimit, Pranimit dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)


e programit të studimit.	Regjistrimit të studentëve që kryen procesin e regjistrimit, respekton të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë. Edhe studentët ekzistues të viteve të dyta dhe të treta të programit të studimit konfirmojnë se procedurat janë të qarta dhe të zbatueshme për të gjithë dhe koordinatori i Departamentit (staf akademik) së bashku me stafin administrativ të sekretarive është shumë ndihmues për ta.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Pranimi i studentëve të rinj mbështetet në kuotat e përcaktuara nga UniBa dhe të miratuara nga MAS. Pranimet e studentëve të rinj në programet e ciklit të parë të studimeve Bachelor bëhen vetëm një herë sipas kohës së përcaktuar nga Ministria. Kriteret e pranimi në UniBa janë publike: <a href="http://umb.edu.al/pranimet.html">http://umb.edu.al/pranimet.html</a> . Një ndër kriteret e pranimi në programin Bachelor është nota mesatare e cila është respektuar. Nga verifikimet me sekretarinë mësimore rezulton se për studentët e programit të studimit Bachelor në Shkenca Politike në vitet akademike 2017-2018 dhe 2018-2019 nota mesatare e studentëve të rregjistruar për herë të parë ka qenë 7.26, tendencë në rritje krahasuar me vitin akademik 2016-2017 ku ka qenë 7.00. Nga ana tjetër, tendenca në rënie e numrit të studentëve nga 11 (2016-2017), në 8 (2017-2018) dhe në 6 (2018-2019) ka sjellë edhe mbylljen e këtij program studimi. UniBa ka traditë në punën me shkollat e arsimit të mesëm në të gjithë vendin por interesi për këtë degë studimi duket që është në rënie. Pranimet UniBa përcaktohen në dokumente specifike për politikën e pranimi (Ev.18-19. Politika e pranimi) dhe shpallen online ( <a href="http://umb.edu.al/pranimet.html">http://umb.edu.al/pranimet.html</a> ).
<b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Institucioni i ka të përcaktuara qartë kriteret për përzgjedhjen e studentëve në programin Bachelor, të shpallura e të kuptueshme në faqen online. Po ashtu, ka të përcaktuara dhe të aplikuarat rregullat e përparimit dhe kalimit nga një vit në tjetrin me 50% të frekuentimit në leksione dhe 75% të frekuentimit në seminare. Me sigurimin e 50% të krediteve ECTS student kalon vitin akademik. Kurse përsa i takon transferimit dhe njohjes së studimeve të mëparshme, ka pasur studentë të ardhur edhe në programin e ciklit të parë Bachelor në Shkenca Politike, ndonëse kanë qenë në numra të pakët: një student në vitin akademik 2016-2017, në vitin e dytë dhe një në vitin akademik 2018-2019, në vitin e parë, duke rritur numrin e studentëve nga 6 në 7 studentë gjithsej. Këto rregulla ishin lehtësisht të kontrollueshme gjatë shqyrtimit të regjistrave në sekretari nga ku u evidentuan këto fakte. Pranimi ishte kryer në përputhje me legjislacionin në fuqi, transferimet e pakta po ashtu (Evidenca 35. Rregullore e Brendshme për transferimet; Evidenca 33: Manual - Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim i studentëve – RVB ka tjetër reference Evidenca 18-19, por që i referohet të njëjtit document).
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Nga biseda me studentët rezultoi se ata ishin të mirëinformuar për kriteret e përgjithshme, ndërsa nuk ka kritere të veçanta të programit të studimit. Kriteret e pranimi janë të shpallura e publike për të gjithë të interesuarit në faqen online UniBa: <a href="http://umb.edu.al/pranimet.html">http://umb.edu.al/pranimet.html</a> . UniBa vë në dispozicion të të interesuarit nëpërmjet faqes zyrtare, mediave sociale, fletëpalosjeve në ambientet e institucionit që në hyrje, informacionin në lidhje me kriteret e programit të studimit Bachelor. Nga biseda me studentët kjo gjë doli e qartë, ndonëse ata e kishin marrë informacionin nga kontaktet me ish studentët e UniBa.
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik politikat e rekrutimit në përputhje me standardet kombëtare dhe nuk ka kritere të veçanta për këtë program studimi Bachelor në Shkenca Politike për të tërhequr sa më shumë studentë, e megjithatë numri shkoi drejt zeros.
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik politikat e rekrutimit në përputhje me standardet kombëtare dhe nuk ka kritere të veçanta për këtë program studimi Bachelor në Shkenca Politike për të pranuar studentë nga shtete të tjera.

<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Institucioni harton politika të ndihmës ndaj studentëve në të gjitha planet, sipë akomodime të atyre që vijnë nga jashtë Tiranës, edhe ndihma financiare për ata në nevojë (Evidenca 37. Politika të mbështetjes, përkrahjes për studentët dhe strukturat organizative të tyre). Nga bisedat e GVJ me sekretarinë dhe studentët nuk rezultoi ndonjë student i mbështetur me bursa për shkak të nevojës, ndonëse institucioni ka politika për mbështetjen me bursa për studentët në nevojë, të cilët, pasi përcaktohen, i çohen për vendim Bordit të Administrimit dhe janë të pasqyruara në evidencat statistikore (Ev.20.1.2 Statistika të rekrutimit 2020-2021). Të dhënat janë në nivel Fakulteti, me bursë të plotë, që paguan vetëm tarifën e regjistrimit dhe me bursë të pjesshme, për studentët e vitit të parë, të dytë dhe të tretë Bachelor.</p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ nga bisedat në institucion me drejtuesit, sekretarinë dhe studentët konfirmon se UniBa lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. Këto procedura janë lehtësisht të kuptueshme, të aksesueshme në faqen online dhe janë zbatuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nga verifikimi i GVJ me sekretarinë mësimore nuk ka pasur kritere specifike, as për studentet vendas me nevoja specifike, as për ata nga trojet, ndonëse nuk kishte ndonjë të tilla. Kriteret e pranimit Bachelor janë njëloj të aksesueshme nga të gjithë.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>UniBa u kushton vëmendje të veçantë marrëdhënieve me studentët. Përmes koordinatorës së departamentit dhe sekretarisë mësimore, studentët informohen në detaje lidhur me vlerësimet për lëndët gjatë gjithë vitit akademik (ndonëse në një rast përcaktohet 0-49 pikë mbetës, në një tjetër 0-50 pikë), sikurse dhe frekuentimi me 50% të orëve në leksione dhe 75% të orëve në seminare. Kalimi në vitin pasardhës bëhet nëse studenti ka grumbulluar 50% të krediteve. Zyra e Rekrutimit, Pranimit dhe Regjistrimit të studentëve dhe sekretaritë mësimore u bëjnë me dije studentëve të gjitha evidencat mbi rezultatet e tyre akademike sipas krediteve të formalizuara në Ligjin 80/2015 (Evidenca 3. Rregullore e Programit të Studimit Shkenca Politike).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Institucioni ka të parashikuara qartë procedurën e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në Rregulloren e UniBA, dhe Rregulloren e Programit të Studimit Shkenca Politike (Evidenca 2; Ev.3. Rregullore e Programit të Studimit Shkenca Politike – Shkurtimi EV=Evidenca, ndryshe nga RVB është për të dalluar dy dokumente të ndryshme me të njëjtin numër), si dhe në Manualin Rekrutim, Aplikim Regjistrim, Transferim (Evidenca 33. Manual - Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim i studentëve– RVB ka tjetër reference Evidenca 18-19, por që i referohet të njëjtit document). Nga biseda me studentët, GVJ kuptoi se ata ishin të mirëinformuar se studentëve iu bëhen me dije të gjitha kriteret dhe procedurat që me fillimin e studimeve në UniBa.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon</p>	<p>GVJ në bisedën me studentët verifikoi se UniBa i informon studentët në lidhje me</p>




<p>studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>procedurat e vlerësimit të dijeve të parashikuara në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në Shkenca Politike, e cila u bëhet e njohur që në fillim të studimeve Bachelor në vit të parë (Ev. 3. Rregullore e Programit të Studimit Shkenca Politike). Në kreun III të kësaj Rregulloreje janë përcaktuar mënyrat e vlerësimit të dijeve të studentëve, e drejta për të hyrë në provim pasi studenti ka ndjekur mjaftueshem orët e leksioneve dhe seminareve, zhvillimi i provimeve, komunikimi i vlerësimit. Krahas njohjes me Rregulloren, kontakteve me koordinatoren e programit dhe sekretaritë, studentët informohen nga çdo pedagog në orën e parë të lëndës, ku prezantohet programi dhe u bëhen të qarta studentëve format e vlerësimit të dijeve, aftësive e kompetencave (verifikimi i syllabuseve ku përcaktohen këto komponentë në mënyrë të unifikuar sipas kuadrit rregullator). Po ashtu, në Rregulloren akademike të UniBa, përcaktohen format e kontrollit dhe të vlerësimit të dijeve (Evidenca 2 Rregullore e UniBa).</p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret e punimit të diplomës dhe diplomimit u bëhen me dije studentëve sepse janë të shprehura qartë në Rregulloren e programit të studimit (Ev. 3. Rregullore e Programit të Studimit Shkenca Politike; Evidenca 5. Paketa e provës finale). Institucioni respekton kuadrin ligjor ku përcaktohet se diploma Bachelor fitohet pas provimit final me shkrim dhe për studentet me mesatare note mbi 9.5 u jepet e drejta për temë diplome. Në provimin e diplomës vendosen çështjet kryesore të të gjitha lëndëve të planit mësimor, që lidhen me kompetencat e domosdoshme profesionale. Deri tani statistikisht tregojnë se janë diplomuar me sukses studentët e Shkencave Politike respektivisht 8 studentë (2018-2019), 9 studentë (2019-2020) 8 studentë (2020-2021), nga të cilët një me temë diplome. Pra, pothuajse të gjithë studentët që kanë hyrë në periudhën 2016-2018 (Të dhëna nga sekretaria mësimore, Tabela 21; Evidenca 23. Tabelat përmbledhëse).</p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>UniBa, përpara fillimit të çdo viti akademik, me qëllim që të rrisë prurjet e studentëve, të cilët janë burimi kryesor i të ardhurave, ka përgatitur një plan vjetor në strategjitë e marketingut (Evidenca 29. Strategjia e marketingut). UniBa që në pranverë fillon me njohjen e maturantëve me programin e studimit Bachelor në Shkenca Politike, i fton ata në aktivitete në mjediset e UniBa ku ju prezantohen detajet e programit të studimit, organizon konkurse, etj. <a href="https://umb.edu.al/nees4850.html">https://umb.edu.al/nees4850.html</a> Në fillim të vitit akademik organizohen Ditët e Akomodimit për studentët e rinj (Evidenca 29.1. Agjenda e Ditëve të Akomodimit).</p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht, pasi UniBa bën një punë të vazhdueshme në informimin e hollësishëm të studentëve mbi të gjitha hallkat e procesit të studimit, si mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në diplomim në këtë program studimi. Kjo provohet me rregulloret ku të gjithë këto komponentë janë përcaktuar qartë, në syllabuset e lëndëve që prezantohen nga pedagogët në orët e para të çdo lende, në punën e palodhur përmes kontakteve me studentët të koordinatores së programit dhe sekretarive, të cilat u konfirmuan nga vizita në institucion dhe biseda me studentët.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p><b>Standardi V.3</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>UniBa e ka traditë që në fillim të vitit akademik informon studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen trevjeçare të programin e studimit Bachelor në Shkenca Politike. Nga biseda me personelin akademik dhe administrativ, konfirmuar edhe nga studentët, ky informacion jepet që në javën e parë të informimit e në vazhdimësi për çdo nevojë që paraqesin studentët. Po ashtu, me fillimin e programit mësimor, pedagogu Koordinator i Departamentit orienton studentët për të gjithë komponentët që kanë lidhje me organizimin e programit të studimit. Fletëpalosjet në mjediset hyrëse të UniBa dhe të dhënat e detajuara në faqen e internetit të UniBa sigurojnë informimin e plotë për programin e studimit Bachelor në Shkenca Politike.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Studentët e programit të studimit Bachelor në Punë Sociale informohen në lidhje me modulet, lëndët dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit nëpërmjet koordinatorit të departamentit dhe pedagogëve përkatës (Ev.2. Dosja e programit). Në fillim të çdo semestri atyre u vihet në dispozicion nga pedagogu i lëndës dhe programi lëndor ku janë specifikuar temat me literaturën e detajuar me faqe dhe format e vlerësimit të dijeve.</p> <p>Gjatë dy viteve të pandemisë së Covid-19, programet lëndore u hodhën edhe në sistemin online, platformën google-classroom dhe pati udhëzues të posaçëm përdorimi të TIK (Ev.23 Udhëzues përdorimi të TIK; Ev. 16. Manuali i programeve; EV.13 Rregullore diplomimi; Ev.26 Model teze provimi lende; ).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Përmes takimeve të ndryshme me Zyrën e Alumnit dhe Karrierës dhe Dekanen e studentëve, si dhe bisedave me studentët, doli qartë veprimtaria e institucionit me qëllim orientimin drejt tregut të punës (Trajnime si të hartojmë një CV dhe letër motivimi: <a href="https://ëëë.umb.edu.al/neës1261.html">https://ëëë.umb.edu.al/neës1261.html</a>). Po ashtu, stafi akademik jo-efektiv i kontraktuar nga Departamenti ofronte praktikat për studentët duke iu ofruar mundësitë e punësimit (Aktivitet mbi punësimin e studentëve në Bashkinë Tiranë <a href="http://ëëë.umb.edu.al/neës1312.html">http://ëëë.umb.edu.al/neës1312.html</a>). UniBa ka eksperiencë duke krijuar një rrjet bashkëpunëtorësh dhe partnerësh me të cilët ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për praktikat profesionale të cilat janë orientuese për tregun e punës (Tregu i punës, çelësi i një karriere të sukseshme: <a href="https://ëëë.umb.edu.al/neës4856.html">https://ëëë.umb.edu.al/neës4856.html</a>). Po ashtu, Bordet e Karrierës të ngritura vitet e fundit punojnë veçanërisht për të përmbushur këtë qëllim (<a href="https://ëëë.umb.edu.al/neës1140.html">https://ëëë.umb.edu.al/neës1140.html</a>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Sikurse u verifikua nga takimet në institucion, studentët informohen mbi gjithë komponentët e zhvillimit dhe organizimit të procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet, si nëpërmjet komunikimeve elektronike, nëpërmjet email-it zyrtar, ashtu dhe përmes komunikimeve të drejtpërdrejta me ta nga Koordinatorin i Departamentit, sekretaria mësimore si edhe Dekani i Studentëve, në mjediset dhe auditoret e UniBa.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>GVJ pas vizitës në institucion konfirmon se sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit është funksional dhe realizon në kohë reale dhe në çdo vend që mund të jenë studentët, edhe në shtëpi, informacion të detajuar në lidhje me programin e studimit, lëndët sipas viteve dhe semestrave, krediteve, etj. i cili publikohet në faqen online të UniBa dhe u niset me emailin personal studentëve. Edhe vlerësimet e testeve, provimeve, detyrave studentët mund t'i gjejnë në portalin studentor: <a href="http://studentportal.umb.edu.al">http://studentportal.umb.edu.al</a></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konkludon se shkalla e përmbushjes së standardit është e plotë. UniBa vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit përmes një serie instrumentesh të verifikuara gjatë vizitës në institucion si: faqes së internetit i aksesueshëm nga të gjithë e kudo që ndodhen, fletëpalosjeve, kontakteve të drejtpërdrejta në auditor nga pedagogët që në orët e para të</i></p>

	mësimi, Zyrës së Alumnit dhe Karrierës, Dekanes së studentëve dhe koordinatores së programit të studimit.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	GVJ, nëpërmjet vizitës në Sekretarinë Mësimore shqyrtoi të dhënat e hedhura në Regjistrat standard në lidhje me studentët e regjistruar në çdo vit akademik në programin e studimit Bachelor në Shkenca Politike, 11 (2016-2017), në 8 (2017-2018) dhe në 6 (2018-2019), si dhe numrin e atyre që diplomohen vit pas viti respektivisht 8 studentë (2018-2019), 9 studentë (2019-2020) 8 studentë (2020-2021), pra pothuajse të gjithë që kanë hyrë në periudhën 2016-2018 (Evidenca 30. Tabelat përmbledhëse, Tabela 21).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	GVJ konfirmon se Sekretaria Mësimore e UniBa mban në mënyrë të rregullt dhe pa gabime nëpër regjistra një bazë të dhënash të detajuara në lidhje me studentët e regjistruar në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Shkenca Politike, studentët e transferuar apo ata që kanë ndërprerë studimet për një periudhë afatshkurtër si edhe ata që janë ç' regjistruar. Ky informacion evidentohet lehtësisht sepse numri i studentëve ishte relativisht i ulët, në kufijte e normave të lejuara për hapjen e programit të studimit, kurse transferime kishte vetëm 2 studentë në periudhën e marrë në shqyrtim (Evidenca 30. Tabelat përmbledhëse, Tabela 21).
<b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Depozitimi i të dhënave për secilin student në Sekretarinë Mësimore, të dhënat për ecurinë e tyre që nga pranimi deri në diplomim, janë të regjistruara si në regjistrin e të dhënave në letër, sipas formateve të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, ashtu edhe në formë elektronike, të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit. Stafi administrativ kishte gatishmërinë maksimale për të njohur GVJ gjatë vizitës në institucion me gjithë dokumentacionin e detajuar që kishin për çdo student (Evidenca 23. Udhëzues për përdorimin e TIK).
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësiteve përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	GVJ konkludon se përdorimi i sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit dhe portalit studentor, ku gjenden të dhënat mbi rezultatet e tyre akademike, edhe me të dhëna të tjera me rëndësi për ta, pasi përpunohen nga sekretaria mësimore, kalojnë për drejtuesit e institucionit. Në dokumentet e shqyrtuara dhe takimi me drejtuesit e institucionit, GVJ gjykon se UniBa ka raporte periodike me analiza vjetore të rezultateve të arritura prej studentëve, si dhe realizimin e objektivave të departamentit për këtë program studimi (Ev 22.1 Analiza e Dept.20-21; Ev 22.2 Analiza e Dept.21-22).
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilit dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre	GVJ ka shqyrtuar raportet për analizën vjetore të Departamentit mbi profilit dhe cilësinë e studentëve, si notën mesatare në hyrje mbi 7 dhe rezultatet e arritura prej tyre deri në diplomim. Zyra e Alumnit ndjek karrierën e tyre pas diplomimit dhe mban kontakte për realizimin e objektivave të departamentit për këtë program studimi. Departamenti në bashkëpunim me zyrën e Alumnit ruajnë komunikime të shpeshta me të diplomuarit e tyre lidhur me punësimin. Pjesë e analizës vjetore janë edhe sugjerimet dhe masat që duhen marrë për përmirësimin e këtyre treguesve (Ev

treguesve.	22.1 Analiza e Dept.20-21; Ev 22.2 Analiza e Dept.21-22).		
<b>Konkluzione</b>	<i>Standardi V.4 Përbushet plotësisht bazuar në faktin që UniBa, sekretaria mësimore mbledh, administron, përfitëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programin e studimit Bachelor në Shkenca Politike. Numri i studentëve ka qenë shumë i vogël, kështu që administrimi i të dhënave nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre kanë qenë lehtësisht të menaxhueshme.</i>		
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në Statutin dhe Rregulloren e Institucionit përcaktohet përfshirja dhe angazhimi i studentëve në organet vendimmarrëse si në Senatin Akademik, në Këshillin e Etikës dhe Shanseve të Barabarta, Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Standardeve të Cilësisë (Evidenca 1.1 Statuti UniBa; Evidenca 1.2. Rregullore e UniBa; Evidenca 37. Politika të Mbështetjes, Përkrahjes për studentët dhe strukturat organizative të tyre; Evidenca 38 Rregullore Qeveria Studentore). Gjatë takimit me grupin e RVB ishte përfaqësuesja e studentëve. Interesante duket që mbledhjet e Departamentit një herë në muaj janë të hapura edhe për studentët.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Përfshirja e studentëve në vendimmarrje garantohet, si përmes përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse, po ashtu edhe nëpërmjet zhvillimit të pyetësorëve në mënyrë periodike për mësimdhënie, që realizohet nga Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë çdo semestër, dy javë përpara mbarimit të tij, me secilin grup, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Rezultatet përcillen në Departament dhe Dekanat si dhe pedagogëve për të reflektuar në mësimdhënie (Evidenca 10. Rregullore e Njësise së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë). Formulari i vlerësimit të studentëve që GVJ iu vu në dispozicion gjatë takimit në institucion përmban 5 komponentë: 1. Organizimi i lëndës; 2. Përmbajtja e Lëndës; 3. Materialet e lëndës; 4. Komponentët e vlerësimit; dhe 5. Pedagogu, për të cilat studentët japin gjykimet e tyre anonime dhe shqyrtoi raportet e vlerësimit të studentëve (Evidenca 11.1 Formulari i vlerësimit të studentëve për lëndën; Evidenca 23.1 Raporti i vlerësimit të studentëve 2021-2022).
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	GVJ gjatë takimit me përfaqësuesit e Njësise së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë dhe shqyrtimit të dokumentacionit, vlerëson përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit (Evidenca 10. Rregullore e Njësise së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë - Në RVB referenca e këtij dokumenti është Evidenca 17.1??; Evidenca 23.1 Raporti i vlerësimit të studentëve 2021-2022). Rezultatet e pyetësorëve u komunikohen me email pedagogëve individualisht dhe përdoren si nga pedagogët, Departamenti dhe strukturat e tjera për të rishikuar lëndën dhe për të përmirësuar mësimdhënien. Studentët njoftohen për rezultatet e vlerësimeve të tyre për çështje të përmirësimit të kurrikulave dhe të mësimdhënies. Në këtë mënyrë, UniBa garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit realizohet përmes pyetësorëve të studentëve
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve,	GVJ gjatë bisedës me studentët dhe stafin akademik vlerëson se të dy palët janë të kënaqur me procesin e vlerësimit të dijeve, aftësive dhe kompetencave. Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve është një proces që ju bëhet me dije studentëve që në fillim të çdo lende, i cili shprehet në Rregulloren e programit të studimit dhe në syllabusin e secilës lëndë. Nga verifikimi i syllabuseve rezultojnë formatet e tyre

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	janë të unifikuara dhe format e kontrollit të dijeve të diversifikuara. Studenëve ju lihet kohë për argumentimin nga pedagogu i lëndës i vlerësimit, nëse kanë pakënaqësi për vlerësimin. Zhvillimi i seancave sqaruese dhe rishikimi i vlerësimit janë tregues i vëmendjes së institucionit ndaj transparencës me studentët gjatë procesit të vlerësimit (Evidenca 1.2. Rregullore e UniBa).		
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se standardi mbi angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese për hartimim, miratimim dhe përmirësimin e programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së shërbimeve ndaj tyre. Nga bisedat me studentët dhe stafet akademike rezultoi se marrëdhëniet mes tyre ishin të hapura, studentët i shprehnin lirshëm mendimet e tyre për lëndët, programin e studimit, metodat e mësimdhënies dhe shërbimet e ofruara për realizimin e mësimdhënies. Studentët konfirmuan se përgjatë çdo viyi akademik, para mbylljes së semestrit, ata jepnin vlerësimin e tyre me shkrim përmes pyetësoreve për të gjithë komponentët e mësipërm për çdo lëndë të programit të tyre mësimor.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	UniBa ka krijuar të gjitha strukturat dhe procedurat e posaçme me qëllim informimin dhe shërbimin e studentëve si Zyra e Pranimimit, Sekretaria Mësimore, Dekani i Studentëve, Zyra e Alumni dhe Karrierës dhe Koordinatorit të Departamentit me të cilët GVJ pati takime gjatë vizitës në institucion. Ato kryejnë funksione në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të UniBa, për shërbimet e kërkuara nga studentët që nga regjistrimi, deri në diplomimin (Evidenca 20.1 Rregullore e zyrave studentore; Evidenca 19.1 Rregullore e Sekretarisë mësimore).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Sikurse u konfirmua edhe nga biseda me studentët në institucion, GVJ konfirmon se ata marrin gjithë shërbimet e kërkuara që nga informimi, këshillimi dhe asistimi për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, si dhe për aktivitete e shërbime brenda e jashtë UniBa-s, për mbarëvajtjen e jetës së tyre studentore. Madje një ndër arsyt pse studentët parapëlqyen të studionin në UniBa ishte edhe gatishmëria e stafit mbështetës për të plotësuar nevojat e tyre studentore.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	UniBa ofron shërbimin e këshillimit për karrierën për studentët dhe në faqen zyrtare të institucionit pasqyrohen të gjitha veprimtaritë e organizuara nga Zyra e Alumni dhe Karrierës dhe Klubi i Karrierës ( <a href="http://umb.edu.al/nees1283.html">http://umb.edu.al/nees1283.html</a> ). Sikurse doli nga biseda e GVJ me studentët, këta orientohen për institucionet ku mund të zhvillojnë praktikën e tyre profesionale, nëpërmjet Koordinatorit të Departamentit dhe pedagogut të përcaktuar për të mbikëqyrur lëndën e praktikës profesionale të parashikuar në planin mësimor të këtij programi studimi (Evidenca 20.1 Rregullore e zyrave studentore; Evidenca 20.3 Strategjia e klubeve studentore 2020-2025).



<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Alumnit dhe Karrierës në UniBa ndjek studentët e diplomuar, komunikon me ta dhe ka siguruar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre. Studentët e diplomuar ruajnë edhe pas diplomimit për një periudhë kohe emailin e UniBa i cili shërben për të vazhduar komunikimet me ta, nëpërmjet adresave të e-mailit, të cilat ruhen edhe një vit pas diplomimit. Zyra e Alumnit dhe Karrierës zhvillon edhe sondazhe me studentët e diplomuar konform rregullave të UniBa dhe i pasqyron rezultatet në raporte vjetore në lidhje me gjurmimin e studentëve të diplomuar (Evidenca 39. Rregullore e zyrave studentore alumni dhe karriera). Zyra e Alumnit dhe Karrierës i mbledh studentët e diplomuar në aktivitete ku ata ndajnë përvojat e tyre dhe informacione për tregun e punës (Barleti Alumni Reunion: <a href="https://ëëë.umb.edu.al/neës4899.html">https://ëëë.umb.edu.al/neës4899.html</a>).</p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ për përmbushjes së standardit në lidhje me funksionimin e procedurave, njësisë së posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve dhe menaxhimin e ankimeve e problematikave të paraqitura nga studentët, vlerëson se UniBa i kryen këto veprimtari në përputhje me kriteret e kërkuara. Studentët janë të kënaqur për pritjen dhe këshillimin e tyre përgjate viteve të studimit në këtë program dhe fakti që ata referojnë studentët pasardhës tregon shume për marrëdhëniet e mira që institucioni krijon me ta.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>


## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

<p><b>Standardi VI.1</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, stafi akademik gjatë bisedës me GVJ, sikurse dhe Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë në UniBa konfirmuan një serë dokumentesh që iu vijnë në ndihmë që nga Udhëzues për metodat e mësimdhënies (Evidenca 11. Udhëzues për metodat e mësimdhënies), për të cilat organizohen edhe trajnime në institucion, deri tek Manual për mësimdhënien online (Evidenca 11.3 Manual për mësimdhënien online), meqë periudha në shqyrtim korrespondon me periudhën e pandemisë.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>GVJ gjatë bisedës me drejtuesin e Njesisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë dhe shqyrtimit të dokumentacionit konfirmon veprimtarinë periodike të monitorimit të mësimdhënies së personelin akademik dhe ndihmësakademik përmes bashkepunimit me Departamentin dhe njësitë e tjera në UniBa (Evidenca 17.1 Rregullore e Njesisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë). Biseda e GVJ me personelin akademik konfirmoi mekanizmat për vlerësimin e mësimdhënies, që nga vlerësimet e drejtuesit të Departamentit deri tek ato të studentëve (Evidenca 11.1 Instrumentet e vlerësimit).</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Biseda e GVJ me personelin akademik dhe me studentët konfirmoi sondazhet periodike për vlerësimin e mësimdhënies për çdo lëndë dhe në fund të çdo semestri (Evidenca 11.2 Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2021-2022 për semestrin e parë dhe të dytë). Studentët nuk shprehën ndonjë ankesë, personeli akademik dhe ndihmës akademik gëzonte respektin e tyre dhe vlerësimet e dijeve të tyre ishin korrekte dhe transparente		
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë dhe Komisioni i Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë si strukturat përgjegjëse bëjnë publike në faqen online të gjitha dokumentet e raporteve të vlerësimit, mbledhjet e Bordit të Administrimit dhe të Senatit në <a href="http://umb.edu.al/dossier-uniba.html">http://umb.edu.al/dossier-uniba.html</a> të verifikuara sipas RVB edhe në internet.		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Përmes mekanizmave të rekrutimit sipas standardeve të cilësisë, vetëvlerësimit të vazhdueshëm në shumë plane të personelit akademik, formateve të ofruara për pedagogët e rinj sa i takon syllabuseve, metodave të mësimdhënies, bibliotekave online, etj., promovon shembuj positive. Institucioni ka garantuar promovimin e modeleve pozitive, saqë studentët në takimin me GVJ theksuan se një prej motiveve të zgjedhjes së UniBa ishin persona publike si E.K., etj., personel akademik me përvojë në UniBa. Këto modele të mira sjellin edhe prurje cilësore në personelin akademik që zhvillon mësim në programin Bachelor në Shkenca Politike (Evidenca 11.6 Përmbajtja e dosjes së pedagogut me kohë të plotë; Evidenca 11.7 Raport i NJZHKC mbi mësimdhënien online gjatë periudhës 10-20 Mars 2020; Evidenca 22.1 Analizë vjetore e Departamentit për vitin akademik 2020-2021).		
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ për standardin VI.1 vlerëson se UniBa ka politika të qarta për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit për programin Bachelor në Shkenca Politike. Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë në UniBa konfirmuan një serë dokumentesh që iu vijnë në ndihmë që nga Udhëzues për metodat e mësimdhënies (Evidenca 11. Udhëzues për metodat e mësimdhënies), për të cilat organizohen edhe trajnime në institucion, deri tek Manual për mësimdhënien online).</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënlige në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UniBa harton politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në përputhje me aktet ligjore në fuqi ( <a href="https://www.umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html">https://www.umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html</a> ) Në Statutin dhe Rregulloren e Uniba, strukturat kryesore përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë janë Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë dhe Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë. Gjate vizitës në institucion u konstatua se ndonëse politikat janë të përcaktuara qartë, strukturat për sigurimin e Cilësisë mbeten ende të paplotësuara me personelin e parashikuar, pasi nga 1+3 specialistë, ishin vetëm përgjegjësi dhe një specialist i kurrikulave, persona me përvojë në këtë fushë (takimi me Përgjegjës të Njësies së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë). Po ashtu, nga takimi me Komisionin e Vlerësimit të Performancës, u konfirmuan procedurat standarde të UniBa për vlerësimin e stafit akademik.

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në Statutin e UniBa, neni 10, 28, në Rregulloren e UniBa, neni 14, 15, në aktet e tyre rregullatore, dhe në Rregulloren e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë përcaktohen dhe zbatohen proceset themelore që ndikojnë në realizimin e plotë të cilësisë së mësimdhënies dhe në zhvillimin e kurrikulave, mbështetur në kuadrin ligjor të arsimit të lartë dhe në vendimet e udhëzimet e strukturave drejtuese të institucionit. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi procedurat e sigurimit të brendshëm të cilësisë ku përfshihen studentët.</p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni i është nënshtruar akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve të studimit nga autoritetet kombëtare në fund të vitit 2021. Programi i studimit Bachelor në Shkenca Politike riakreditohet pavarësisht se ai është mbyllur si i tillë, për studentët e fundit që presin të diplomohen nga ky program. GBJ konfirmon se njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë ka specialistë me përvojë, ish specialistë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe ata bashkëpunojnë ngushtë me njësitë e tjera kryesore të Uniba si burimet njerëzore, zyrën e Alumnit dhe Karrierës, zyrën e pranimeve, dekanen e studentëve dhe bashkëpunëtorët e jashtëm për vlerësimin e cilësisë (Takimi me dy përfaqësuesit e zyrës së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë). Për vlerësimin e procesit të mësimdhënies mblidhen të dhëna nga stafi akademik nga njësitë bazë e kryesore, nga studentët nga të diplomuarit nga stafi administrativ dhe mbi bazën e analizave krahasuese të tyre gjykohet për përmirësim të proceseve që promovojnë e përmirësojnë cilësinë (Takimet në institucion me të gjithë përfaqësuesit e stafit akademik, administrativ dhe studentëve).</p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Referuar Manualit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, struktura përgjegjëse ndjek procedura periodike për sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në Shkenca Politike dhe përdor tregues të qartë, të matshëm në vlerësimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor për pasqyrimin e arritjeve dhe dobësive. Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ gjatë vizitës në UniBa konfirmon se ka një paketë me instrumente për sigurimin e cilësisë që përbëhet nga formularë standardë për syllabuset e lëndëve, të cilët u ofrohen pedagogëve të rinj apo personelit akademik me kontratë për të siguruar një vazhdimësi të lëndës (konfirmuar edhe nga biseda me stafin akademik). Stafi akademik konfirmoi fleksibilitetin për të ndryshuar syllabuset. Po ashtu, u verifikuan pyetësorët për vlerësimin e pedagogëve nga personeli akademik dhe studentët që aplikohen periodikisht në fund të semestrit për përmirësimin e procesit mësimor, duke krijuar kulturën e rritjes së cilësisë në nivel institucional.</p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ për standardin VI.2, vlerëson se sigurimi i brendshëm i cilësisë është një procesi që UniBa e organizon dhe monitoron në mënyrë të vazhdueshme për garantimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Ndonëse politikat dhe procedurat janë të përcaktuara qartë, strukturat për sigurimin e cilësisë mbeten ende të paplotësuara me personelin e parashikuar, megjithatë ato duke bashkëpunuar me të gjitha strukturat e tjera, garantojnë sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në vazhdimësi UniBa i është nënshtruar dhe akreditimit të jashtëm institucional dhe të programeve të veçanta, përfshirë programin Bachelor në Shkenca Politike.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

**Standardi VI.3**

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	studentëve që dalin nga databaza e studentëve të punësuar konfirmojnë suksesin e programit të studimit. Stafi akademik me kontratë gjithashtu raporton për ecurinë e procesit mësimor dhe ofron ekspertizën e tij kur ftohet në diskutime rreth përmirësimit të cilësisë së programit të studimit.						
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ në lidhje me standardin VI.4 vlerëson se ai përmbushet plotësisht bazuar në gjetjet në pjesën përshkrimore. UniBa monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet përmes metodave të drejtpërdrejta, dhe jo të drejtpërdrejta. Departamenti organizon takime mujore periodike për ecurinë e procesit mësimor, të cilat pasqyrohen në raportet vjetore të punës së Departamentit, ku krahas mendimeve të pedagogëve, përfshihen edhe vlerësimet e studentëve për lëndët. Metoda jo të drejtpërdrejta janë monitorimi i syllabuseve nëse janë konform formateve të përcaktuara nga Departamenti, rezultatet e studentëve në provime dhe në detyrat e kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit, si dhe rezultatet e gjurmimit të punësimit të studentëve. Gjithashtu, bashkëpunëtorët e departamentit ftohen në diskutime rreth përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit.</i>						
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

#### Standardi VI.4

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Nga shqyrtimi i Rregullores së Standarteve dhe Cilësisë përcaktohet se 4 prej anëtarëve të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë janë përfaqësues të personelit akademik, përfshirë edhe përfaqësues të personelit akademik me kohë të pjesshme, të cilët janë ekspertë të fushës në institucione të ndryshme publike dhe OSHC, si Bashkinë e Tiranës, etj. (Evidenca 8.1 Rregullore e Standarteve dhe Cilësisë, Neni 4). Nga takimi në institucion, GVJ konfirmon se UniBa garanton përfshirje të aktorëve të brendshëm dhe jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit Bachelor në Shkenca Politike.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	UniBa ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për Anëtarët përbërës të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë dhe Njësive të Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, në përshtatje edhe me rolet që ata kanë në Rregulloren e UniBa, Rregulloren e Komisionit dhe Rregulloren e Njësive të Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë. Planet e punës të këtyre njësive (Evidenca 66 - Plani i punës NJZHKC 2020-2021) tregojnë se këto detyra zbatohen në praktikë dhe GVJ e konfirmoi këtë edhe nga takimet në institucion.
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit,	Në vlerësimin e sigurimit të cilësisë së programit të studimit Bachelor në Shkenca Politike garantohet përfshirja e personelit akademik nga Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit, njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit, stafit ndihmës administrativ dhe studentët – 1 përfaqësues i të cilëve ishte në GVB me të cilët GVJ realizoi takimin gjatë vizitës në institucion. Metodologjia

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	dhe procesi i hartimit të RVB e përshkruar në hyrje të raportit dhe e konfirmuar nga biseda me grupin e vlerësimit të brendshëm tregon përfshirjen e përfaqësuesve nga Departamenti, anëtarë të personelit akademik, nga personeli administrativ dhe një student i këtij programi studimi.		
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	UniBa ka përcaktuar standarde në Kodin e Etikës që të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe të drejtave të studentëve të përfshirë në proceset ciklike të vlerësimit (Evidenca 59 Kodi i Etikës). GVJ nga biseda me stafin akademik dhe zyrat respektive që merren me vlerësimet konfirmon se komunikimi i rezultateve të vlerësimit të stafit akademik bëhej në mënyre individuale për çdo personel akademik dhe problematikat në përgjithësi diskutoheshin në mbledhjet e Departamentit për të marrë vendime unanime.		
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Proceset e vlerësimit të programit të studimit përfshijnë në diskutime edhe bashkëpunëtorët e Departamentit, të angazhuar si staf akademik i jashtëm, apo ata që monitorojnë praktikën e studentëve, që janë përfaqësues të institucioneve partnere, apo ish student alumni. Mendimet dhe ekspertiza e tyre vjen nëpërmjet diskutimeve në mbledhjet e departamentit, aktiviteteve të përbashkëta, si projekte, konferenca, etj. GVJ e konfirmon këtë pas bisedave me stafin akademik efektiv dhe me kontratë të UniBa, si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit që pasqyrojnë aktivitetet e përbashkëta të Departamentit me partnerët.		
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konkludon se standardi VI.4 përmbushet plotësisht. UniBa përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra. Referuar faktit se UniBa ka përcaktuar standarde në Kodin e Etikës që të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe të drejtave të studentëve të përfshirë në proceset e vlerësimit (Evidenca 59 Kodi i Etikës), si dhe nga takimet me stafin akademik dhe zyrat respektive që merren me vlerësimet, GVJ konfirmon se komunikimi i rezultateve të vlerësimit të stafit akademik bëhej si në mënyre individuale për çdo personel akademik, edhe në mbledhjet e Departamentit për të marrë vendime unanime për përmirësimet e nevojshme. GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit që pasqyrojnë aktivitetet e përbashkëta të Departamentit me partnerët, vlerëson se partnerët janë pjesëmarrës në procesin e vlerësimit.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	UniBa ka në faqen zyrtare informacionin e kërkuar, si kusht kryesor i transparencës për studentët dhe të gjithë të interesuarit. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë publikohen në kohë reale në faqen online: <a href="https://umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html">https://umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html</a> dhe të zyrës së performancës: <a href="https://www.umb.edu.al/mps.html">https://www.umb.edu.al/mps.html</a>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të	Rregullorja e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë në nenin 2 të saj



Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	përmban parimet mbi të cilën bazohet sigurimi i brendshëm i cilësisë (Evidenca 10. Rregullore e NjZHKC). Vlerësimi kryhet në nivel institucional, dhe rezultatet e tij iu bëhen me dije strukturave drejtuese. Struktura drejtuese i përcjell rezultatet në njësinë bazë dhe ato elementë që lidhen me këtë njësi. Në departament trajtohet me personelin akademik ato elementë të vlerësimit që lidhen ngushtë me veprimtarinë e tyre. Raportet e NJZHKC-së janë transparente dhe publikohen në seksionin e Sigurimit të Cilësisë në faqen e ëeb site-it të UniBa dhe në seksionin e Vlerësimit të Performancës. GVJ hyri në këto site dhe konfirmoi publikimin e tyre. (00 RVB i BSc ne Shkenca politike)						
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Institucioni realizon në vijueshmëri procesin e përpilimit të rezultateve dhe masave që duhet të ndërmerren si rezultat i raportit. Struktura të universitetit me Urdhër të Rektorit vihen në lëvizje për adresimin hapave që lidhen me përmirësimin e mangësive. Nga shqyrtimi i evidencave disa nga masat e marra lidhen me aktivitete për ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve akademike përmes realizimit të seminareve të trajnimit me natyrë didaktike të mësimdhënies apo për kërkimin shkencor. (Ev 11.5.1 Udhezime rektori – rekrutimet; Ev 11.7 Raportim i NJZHKC-mesimdhënia)						
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Përpjekjet për të reflektuar gjetjet e raportit sikundër dhe monitorimin janë në nivel institucional. Përmes kontrollit të kryqëzuar, strukturat dhe aktorë të brendshëm të UniBa reflektojnë mbi rezultatet e raportit dhe realizojnë masa që lidhen me programet e studimit për ta përmirësuar më tej. Përmirësimet lidhen me përditësimin e lëvizësive (asaj bazë dhe të detyrueshme), temave të syllabuseve apo dhe ndryshime në masën 20% të programit etj. (00 RVB i BSc ne Shkenca politike)						
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Realizimi i vlerësimit të përvitshëm nga ana e NJZHKC-së përmes planit të punës mundëson angazhimin e strukturave akademike dhe studentët në proces. Aksesi në dokumentat ku bazohet kjo veprimtari është e mundur si për stafin akademik, administrativ dhe studentët në nivel institucional. (00 RVB i BSc ne Shkenca politike)						
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë publike, transparente dhe efektive referuar faqes online të UniBa me info për aktivitetet në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë.</i>						
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

**Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>






**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Politike” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Barleti”**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. UniBa ka hartuar vizione të qarta për zhvillimin e programit mësimor Bachelor në Shkenca Politike;
2. UniBa disponon një kuadër të plotë ligjor dhe rregullator, që mundëson disiplinimin e procesit mësimor e kërkimor – shkencor.
3. Institucioni ka një praktikë shumë të mirë të ruajtjes së dokumentacionit sipas standardeve dhe kërkesave ligjore dhe nënligjore në fuqi;
4. Strukturat institucionale sigurojnë standartet e cilësisë dhe garantojnë një proces mësimor transparent për studentët dhe subjektet e tjera të interesuara;
5. Institucioni ka procedura të vlerësimit të stafit në disa nivele që nga drejtuesi i Departamentit, ZMBNJ, personeli akademik, studentët dhe vetëvlerësimi që secili bën për përmbushjen e detyrimeve. Këto vlerësime i referohen disa shtyllave kryesore: shtylla akademike, e cila përfshin të gjitha veprimtaritë e procesit të mësimdhënies; shtylla e kërkimit shkencor; shtylla e studentëve dhe marrëdhënieve me komunitetin; shtylla administrative dhe shtylla e sipërmarrjes;
6. UniBa ka mjedise bashkëkohore, që nga sallat e leksioneve, bibliotekat, mjediset shplohëse e argëtuese, restorantet, deri tek qendrat sportive;
7. UniBa ka një infrastrukturë të përshtatshme me pajisje teknologjike, akses në internet, biblioteka online, si dhe një sistem informatik eficient dhe përdor platforma dixhitale që i vijnë në ndihmë studentëve, duke mundësuar akses dhe informim në kohë reale. Ato kanë qenë evidente veçanërisht për periudhën e pandemisë së Covid -19, e cila i korrespondon periudhës së akreditimit të programit të studimit;
8. UniBa është një institucion me përvojë disa vjeçare dhe ka nënshkruar marrëveshje me një rrjet të gjerë bashkëpunëtorësh në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar, duke mundësuar ndarjen e eksperiencave, cilësi të lartë të mësimdhënies dhe lidhjen e teorisë me praktikën, si dhe kryerjen e praktikave profesionale të cilat kanë mundësuar më pas edhe punësimin e të diplomuarve.




## **Pika të dobta**

1. Institucioni mbështetet kryesisht në tarifën e shkollimit të studentëve dhe është vulnerabël ndaj trendit në ulje të numrit të studentëve për këtë program studimi;
2. Personeli akademik efektiv duhet të pajiset me tituj dhe grada shkencore pasi katër prej tyre janë vetëm MSc.;
3. Mbingarkesa mësimore e stafit akademik nuk ka ndryshuar, të gjithë janë mbi normat standarde të përcaktuara me Udhëzimin nr.29, datë 10.09.2018 të Ministrisë së Arsimit e Sportit;
4. Veprimtaria kërkimore kufizohet me rregulla burokratike në Manualin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore si deri në 7 ditë të pagueshme leje për kualifikime (konferenca, aktivitete trajnimi, etj.) dhe deri në 30 ditë leje pa të drejtë page;
5. Ndonëse institucioni ka mjedise dhe mundëson bibliotekat online, programi i studimit ka nevojë për literaturë bashkëkohore në format të printuar.

## **Rekomandime**


1. Institucioni të investojë më shumë në kërkimin shkencor dhe projekte për të krijuar një larmishmëri burimesh financimi. Veprimtaria kërkimore të mos kufizohet me rregulla burokratike në Manualin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;
2. Me qëllim që të nxitet personeli akademik në avancimin e titujve dhe gradave shkencore, institucioni të reduktojë ngarkesën mësimore të stafit akademik me qëllim që t'i lihet më tepër kohë kërkimit shkencor;
3. Stafi akademik duke punuar në fushën e kërkimit shkencor për marrjen e gradës Doktor, do të realizojë më shumë produkte si artikuj në revista shkencore, si brenda edhe jashtë vendit;
4. Departamenti që ofron këtë program studimi të bashkëpunojë me aktorët e tjerë për të riorganizuar programin që të ketë aftësi konkurruese në treg;
5. Fondi i librave në Bibliotekën e UniBa për programin e studimit ka nevojë të pasurohet me literatura bashkëkohore që të mundësojë përditësimin e literaturës për sillabuset e lëndëve.



## **Conclusions of the evaluation of the first cycle Bachelor's study program in "Political Science" offered by the Institution of Higher Education "Barleti University"**

### **Strengths**

1. UniBa has drawn up clear visions for the development of the Bachelor's program in Political Science;
2. UniBa has a complete legal and regulatory framework, which enables the realization of teaching and research-scientific process.
3. Institution has a very good practice of preserving documentation according to the standards and legal and by-law requirements in force;
4. Institutional structures ensure quality standards and guarantee a transparent learning process for students and the interested subjects;
4. The institution has staff assessment procedures at several levels from the head of the Department, HR office, academic staff, students and the self-assessment that each makes for the fulfillment of institutional obligations. These evaluations refer to several main pillars: the academic pillar, which included all the activities of the teaching process; pillar of scientific research; student and community relations pillar; the administrative pillar and the entrepreneurial pillar;
5. UniBa has contemporary facilities, from lecture halls, libraries, recreational and entertainment facilities, restaurants, to sports centers;
6. UniBa has an appropriate infrastructure with technological equipment, internet access, online libraries, as well as an efficient IT system and uses digital platforms that help students, enabling access and information in real time. It has been evident especially during Covid-19 pandemic situation that refers to the period of accreditation of this study program;
7. UniBa is an institution with several years of experience and has signed agreements with a wide network of collaborators at the local, regional and international level, enabling sharing experiences, high quality teaching and connection of theory with practice, as well as realization of the students' internships which had enabled then the students' employment.



## **Weaknesses**

1. The institution relies mainly on student tuition fees and is vulnerable to the downward trend in the number of students for this study program;
2. The effective academic staff should be equipped with scientific degrees since four of them are only MSc.;
3. The teaching overload of the academic staff has not changed, everyone is above the standard rates defined by the Instruction no. 29, dated 10.09.2018 of the Ministry of Education and Sports;
4. Research activity is limited by bureaucratic rules in the Human Resources Management Manual such as up to 7 paid days of leave for qualifications (conferences, training activities, etc.) and up to 30 days of unpaid leave;
5. Although the institution has facilities and enables online libraries, the study program needs contemporary literature in printed form.

## **Recommendations**

1. The institution should invest more in scientific research and projects to create a diversity of funding sources. The research activity should not be limited by bureaucratic rules in the Human Resources Management Manual;
2. To encourage the academic staff in the advancement of scientific titles and degrees, the institution should reduce the teaching load of the academic staff in order to leave time for scientific research;
3. The academic staff, working in the field of scientific research to obtain the Doctor's degree, will produce more products such as articles in scientific journals, both inside and outside the country;
4. The department that offers this study program should cooperate with other actors to reorganize the program to be competitive in the market;
5. The book fund in the UniBa Library for the study program needs to be enriched with contemporary literature to enable updating the literature for the course syllabuses of this study program.

